# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7369 E enjte 30 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Opinioni i Ditës

Nga BEN ANDONI

## Kosova dhe Shqipëria, sa shumë fjalë... për ndarjen



Me mbledhjet e përbashkëta, që përsëriten kaq shpesh, qeveritë respektive të Kosovës dhe Shqipërisë kanë gjetur një element shumë interesant kur duan ...

Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga LORENC VANGJELI

## Shqipëria, si një kartë krediti për hipokritët

Festat e Nëntorit, ashtu siç i quanin dikur komunistët, janë një shans i shkëlqyer për shpërthime ndjenjash patriotizmi në vend. Edhe këtej, edhe përtej kufijve ...

Vijon në faqen 21



Profesorët e Albanologjisë, pa honorare

# 8 vite pa marrë pagesat, shteti u ka 40 milionë lekë borxh akademikëve

Rreth 300 mijë euro detyrime financiare, flet drejtori i Qendrës së Studimeve, Marenglen Verli

Nga FATMIRA NIKOLLI

Akademia e Studimeve Albanologjike, emri i ri që ka marrë Qendra e Studimeve Albanologjike, e ngritur gjatë qeverisë "Berisha" me institutet e shkëputura nga Akademia e Shkencave, ka prej disa muajsh një ...

Në faqet 18-19

OPERACIONI MASIV NE BRESHIA, SHKATERROHET GRUPI QE TRAFIKONTE HASHASH

# RRJETI I DROGES NE ITALI, 12 SHQIPTARE NE PRANGA

Rrugët e hashashit që vinte nga Shqipëria. Kapet korrieri në Sicili, arrestohen 4 italianë. Në Greqi zbardhet dëshmia e shqiptarëve në gjyq



*(Në foto)* 41-vjeçari i arrestuar, Vladimir Kapaj. Drogë (foto ilustruese)

Në faqet 2-3

DOKUMENTET

## Certifikimi i mjekëve, dalin datat e provimit

Në faqen 9

FLET ARJOLA ALIKA

## Shifra e frikshme, rreth 3 mijë raste dhune ndaj grave vetëm në 6 muaj

Në faqen 8

VARREZAT E DESHMOREVE

## Dita e Çlirimit, Meta-Rama bashkë për homazhe tek "Nënë Shqipëri"

Në faqen 5

PROPOZIMET

## Projektbuxheti i 2018, zbardhen amendamentet e PD sot në Kuvend

Në faqen 6

NDERTIMET PA LEJE



## ALUIZNI: 200 familjet që kanë gati lejet e legalizimeve

Në faqen 14

Sherri tek "Parku" në Tiranë, policia shpall në kërkim 23-vjeçarin me nënshtetësi gjermane

# Polici i plagosur: I njoh dy autorët

*Zbardhet dëshmia e efektivit Ermal Bregu: Më thanë pse shikon e më qëlluan*

Nga INA ALLKANJARI

Njëri prej tyre më tha 'pse na shikon'. Gjithçka ndodhi në pak minuta për arsye banale", kështu ka dëshmuar dje para forcave policore, Ermal Bregu, efektivi i plagosur mbrëmjen e së martës, në rrugën "Kongresi



Ermal Bregu



Daniel Malusha

i Lushnjës" në Tiranë. Gjatë dëshmisë së dhënë, 33-vjeçari ka identifikuar dy autorët, të cilët ai tha se i njihte dhe ka mohuar që të ketë pasur konflikte të mëparshme me ta. "Dy personat i njoh, sepse jemi në një lagje. Nuk kam pasur ...

Në faqen 11

# TRAFIKU I DROGES
## ARRESTIMET

Policia e Shtetit nis kontrollet e banesave, ja emrat e tre trafikantëve shqiptarë

# Gomonia me 1.6 tonë kanabis, gjykata e Pireut në Greqi lë në burg 3 skafistët

## *Shqiptari: S'kam lidhje me drogën, isha ngarkues*

Ina Allkanjari
Arbër Sulo



I arrestuari Arban Baxheri

**GREQI**

Pesë ditë pas kapjes së gomones me 1.6 tonë drogë, e nisur nga Himara dhe arrestimit të 11 personave në kuadër të këtij operacioni, gjykata e Pireut në Greqi, dha dje masën e sigurisë për tre nga trafikantët. Gjykata la masën arrest me burg pa afat për tre të pandehurit të përfshirë në trafikun e drogës. Trupa gjykuese vendosi masën e sigurisë për dy shqiptarë dhe një italian. Gjithashtu, televizioni publik grek, ERT njoftoi se dje tre nga trafikantët që u kapën brenda gomones 12 metra, një shqiptar, një italian dhe një bullgar janë dërguar në prokurorinë e Pireut për t'u marrë në pyetje. Bëhet me dije se dëshmitë e tyre do të jenë vendimtare për të zbardhur më shumë detaje nga kjo ngjarje. Mësohet, gjithashtu, se ditën e sotme dhe nesër do të dërgohen në prokurori për të dëshmuar edhe 8 persona të tjerë. Sakaq autoritetet policore shqiptare kanë kryer kontrolle në banesat e gjashtë shqiptarëve të arrestuar në Greqi si të përfshirë në trafikun e drogës.

**SEANCA GJYQËSORE**

Gjatë seancës gjyqësore të zhvilluar dje në gjykatën e Pireut në Greqi, u dha masa e sigurisë arrest me burg pa afat për tre nga trafikantët e përfshirë në organizatën kriminale të drogës. Përpara trupës gjykuese një nga shqiptarët ka mohuar të ketë lidhje me drogën, pasi sipas tij ishte marrë në punë për ngarkim-shkarkim, pa pasur dijeni se çfarë ngarkese ishte. "Më thanë: Eja të shkarkosh disa gjera nga një skaf,- nuk kam lidhje me drogën",- ka thënë ai. Ndërkohë sipas prokurorisë së Pireut, italiani i përfshirë në trafikun e drogës ishte në rolin e organizatorit. Akuzë e cila u mohua nga ky i fundit. "Kisha marrëveshje thjesht për drejtimin e skafeve Skipper nga Greqia në Itali"- ka thënë italiani në seancën gjyqësorë. Pasi dëgjoi palët, gjykata e Pireut ka lënë në burg 2 shqiptarët dhe italianin. Ndërkohë gjykata e Pireut pritet të japë sot masën e sigurisë për një italian dhe dy shqiptarë të tjerë dhe të premten për pjesën e mbetur.

**KONTROLLET E BANESAVE**

Në kuadër të këtij operacioni, kanë rënë në pranga 11 persona, mes të cilëve 6 shqiptarë, 2 italianë, 2 grekë dhe 1 bullgar. Mediat greke, referuar burimeve nga hetuesit, kanë publikuar emrat e 3 shqiptarëve, të cilët kanë rënë në pranga. Bëhet fjalë për Arban Baxheri nga Saranda, Ervis Çaushaj nga Përmeti si dhe Emiliano Kola nga Vlora. Gjithashtu, dyshohet se pjesë e grupit është edhe një person tjetër me inicialet B. K. nga fshati Zhepovë i Përmetit. Për këtë të fundit ende nuk ka të dhëna të sakta, por mësohet se policia është vënë në kërkim të tij. Ndërkohë burime konfidenciale bëjnë me dije se për rastin në fjalë është informuar policia e Sarandës, e cila ka kryer kontrolle në banesat e gjashtë shqiptarëve të arrestuar në Greqi. Mësohet se gjatë kontrollit në banesën e të pandehurit Emiliano Kola, nuk janë gjetur të dhëna komprometuese. Ndërsa policia ka konstatuar se familja e Ervis Çaushti, nuk jeton në Përmet prej kohësh dhe nuk kishte asnjë banesë në pronësi. Ai dhe familja e tij rezultojnë të jenë larguar në Greqi pak vite më parë. Sakaq mësohet se i pandehuri Arban Baxheri, 32 vjeç është i martuar dhe ka një fëmijë dhe njihet në qytetin bregdetar si pronar i një dyqani celularësh, por aktualisht në emër të tij nuk rezulton asnjë biznes. Ndërkohë, Baxheri është një emër i njohur për policinë e Sarandës. Ai është shoqëruar disa herë për dyshime që lidhen me përfshirjen e tij në trafikun e drogës, por më pas është lënë i lirë. Në 18 gusht 32-vjeçarit iu bë pritë afër banesës në Sarandë nga tre persona që e goditën në sy të djalit të tij, me shkop bejsbolli dhe thikë pranë zemrës. Baxheri mori plagë të rënda dhe pasi u mjekua në Sarandë u transportua në Janinë. Dyshimet për këtë rast kishin të bënin me konfliktet për pazaret e drogës. Tre autorët, të cilët plagosën Baxherin u lanë të lirë nga gjykata.

11

**ARRESTIME**

Gjatë operacionit antidrogë, policia greke ka arritur të kapë një gomone transoqeanike të mbushur me 1.6 tonë drogë. Policia njofton se në kuadër të këtij operacioni kanë rënë në pranga 11 persona, mes të cilëve 6 shqiptarë, 2 italianë, 2 grekë dhe 1 bullgar.

## Dëshmia



**TRAFIKANTI SHQIPTAR**

Një nga shqiptarët gjatë seancës gjyqësore ka mohuar të ketë lidhje me drogën, pasi sipas tij ishte marrë në punë për ngarkim-shkarkim, pa pasur dijeni se çfarë ngarkese ishte. "Më thanë: Eja të shkarkosh disa gjera nga një skaf,- nuk kam lidhje me drogën"- ka thënë ai.



Droga dhe sendet e sekuestruara nga polica greke

**3 SHQIPTARET E ARRESTUAR NE GREQI**

| | |
|---|---|
| ■ ARBAN BAXHERI | SARANDË |
| ■ ERVIS ÇAUSHAJ | PËRMET |
| ■ EMILIANO KOLA | VLORË |



### "Bosi i madh" dyshohet se jeton në një vilë në bregdet

## Droga, mediat greke: Në kërkim shqiptari me pseudonimin "Vito"

**GREQI** - Policia greke vijon hetimet për arrestimin e çdo anëtari të organizatës kriminale që transportonte drogë nga brigjet shqiptare. Rreth 1.6 tonë drogë u kapën pesë ditë më parë në një operacion të madh që përfshiu një numër të madh efektivësh policie, të Rojës Bregdetare greke dhe madje edhe Frontex. Pas arrestimit të 11 persona të përfshirë në këtë organizatë kriminale policia greke ka folur për një "bos" të madh shqiptar. Dje gazeta "To Vima", shkruan se grupi kriminal ishte i trajnuar për taktika anti-ndjekje dhe përdornin automjete me targa të huaja. Një pjesëtar kryesor i grupit konsiderohet një 31-vjeçar me shtetësi italiane dhe origjinë shqiptare, i njohur me pseudonimin "Vito". Pas sekuestrimit të sasisë prej 1.6 tonë drogë nga autoritetet në brigjet e Kostandinopojës, policia greke është vënë në kërkim të "bosit të madh" që thuhet se jeton në një vilë në bregdet.

> Pas arrestimit të 11 personave të përfshirë në këtë organizatë kriminale, policia greke ka folur për një "bos" të madh shqiptar.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA:** Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet:** www.balkanweb.com, **Email:** gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



### Për mirëmbajtjen e mjeteve shpenzoheshin 50-60 mijë euro

# Megaoperacioni antidrogë, mediat greke: Me motoskafë transportoheshin edhe refugjatë

**GREQI** - Përveç sasive të mëdha të drogës, skafet e fuqishëm të organizatës shqiptaro-greke nuk transportonin vetëm lëndë narkotike. Sipas autoriteteve të vendit fqinj, të cilat kanë dhënë informacione shtesë në lidhje me këtë mega-operacion, me këto skafe që trafikohej marijuanë janë transportuar edhe refugjatë. Këtë e tregojnë dokumentet e rojeve bregdetare të Greqisë. Njëri prej motoskafëve të fuqishëm i quajtur "Ionion", në verën e vitit 2011 kishte trafikuar refugjatë nga Greqia në Itali, citon TV "Klan". Mjeti lundrues i përket biznesmenit 63-vjeçar, Spiros Kardamis nga Mikonos, i cili tashmë është i arrestuar. Gjithashtu, mediat greke raportojnë se ky biznesmen ka në pronësi rreth 6 motoskafë të fuqishëm, që përdoreshin për trafikun e drogës në itinerarin Shqipëri-Greqi-Itali-Turqi. Biznesmeni grek u mundësonte infrastrukturën trafikantëve, duke u vendosur në dispozicion këto skafe të fuqishme. Për mirëmbajtjen e tyre të vazhdueshme shpenzoheshin 50 mijë deri në 60 mijë euro, në mënyrë që të mos kishin të papritura gjatë rrugës. Gazeta "Kathimerini" bën me dije se grupi arriti në mes të shtatorit të trafikojë nga Shqipëria në Turqi një sasi të madhe hashashi. Avokati Gianis Glikas është shprehur për klientin e tij Spiros Kardhamis: "Kjo është rrota e fundit e makinës, e cila operonte në raste urgjente". Referuar burimeve nga hetuesit në Athinë, mediat greke raportojnë se drejtuesi i kësaj organizate të fuqishme është një 31-vjeçar italian me origjinë shqiptare, i quajtur Vito. Për të njëjtin person, disa ditë më parë këto media thanë edhe se zotëron vilë në bregdetin shqiptar, megjithëse nuk dihet vërtetësia e këtyre informacioneve.



Gomonet e sekuestruara në Greqi

**BIZNESMENI GREK**

Biznesmeni grek, Spiros Kardamis u mundësonte infrastrukturën trafikantëve, duke u vendosur në dispozicion këto skafe të fuqishme. Për mirëmbajtjen e tyre të vazhdueshme shpenzoheshin 50 mijë deri në 60 mijë euro, në mënyrë që të mos kishin të papritura gjatë rrugës. Avokati Gianis Glikas është shprehur për klientin e tij Kardhamis: "Kjo është rrota e fundit e makinës, e cila operonte në raste urgjente".



## Kapet korrieri shqiptar në Sicili, droga me vlerë 75 mijë euro

**ITALI** - Autoritetet italiane kanë arrestuar një transportues droge shqiptar gjatë një operacioni antidrogë në Misterbianco, në provincën e Katanias. Bëhet fjalë për 41-vjeçarin Vladimir Kapaj, i cili u prangos nga karabinierët sapo mbërriti në vendin e caktuar për dorëzimin e një sasie prej 31 kg marijuanë dhe 850 gr kokainë. Bazuar në informacionet e siguruara gjatë hetimit, policia italiane priste mbërritjen e korrierit shqiptar, Kapaj. Ndërkohë, ra në pranga edhe personi që priste t'i dorëzohej droga. Dhe konkretisht, italiani 39-vjeçar, Agatino Piano. Mediat vendëse raportojnë se sapo shqiptari mbërriti me një makinë tip "Opel" në vendin e dorëzimit, policët ndërhynë menjëherë dhe e arrestuan. Mësohet se Vladimir Kapaj banon në një fshat të provincës së Katanias. Gjatë kontrollit të ushtruar në makinë, atij iu sekuestruan 3 thasë me 31 kg marijuanë si dhe dy pako me kokainë, 850 gr gjithsej, e 25 gr hashash. Vlera e drogës ishte rreth 75 mijë euro.

Grupi kriminal ka trafikuar tonelata marijuanë nga Shqipëria e kokainë nga Holanda

# Shkatërrohet rrjeti i drogës në Itali, përfundojnë në pranga 12 shqiptarë

## Arrestohen 4 italianë, në kërkim edhe 4 persona të tjerë

**ITALI**

Një tjetër organizatë kriminale që kontrollonte trafikun e drogës mes Shqipërisë, Italisë dhe Holandës është zbuluar dhe shkatërruar nga policia italiane. Gjatë operacionit masiv antidrogë, karabinierët e qytetit të Breshias (në veri të vendit fqinj), kanë arrestuar 16 persona, 12 prej tyre shqiptarë dhe 4 të tjerë italianë (mes të cilëve një grua). Mësohet se prokuroria ka lëshuar urdhër-arreste edhe për 4 persona të tjerë, të cilët janë ende në kërkim. Mes të kërkuarve janë edhe dy shtetas shqiptarë, emrat e të cilëve nuk bëhen me dije. Dyshohet se ata fshihen në qytetin e Vlorës.

### OPERACIONI ANTIDROGË

Sipas informacioneve paraprake, grupi kriminal furnizonte me drogë kryesisht tregun italian. Marijuanën e merrte nga Shqipëria, ndërsa kokainën nga Holanda. "Është një organizatë kriminale që importonte kokainë nga Holanda dhe marijuanë nga Shqipëria nëpërmjet kanaleve dhe mekanizmave të ndryshëm që nga fundi i vitit 2016", thanë burimet nga policia italiane. Kështu, në "rrjetën e peshkut" përfunduan korrierë e tregtarë të drogës. Nga Holanda shkonin drejt Italisë kilogramë kokaine në çdo udhëtim. Ndërsa, rezulton se rrjeti ka trafikuar dhjetëra tonelata marijuanë nga Shqipëria. Si bazë kishin një zonë pranë Vlorës, nga ku lënda narkotike nisej me gomone drejt Italisë. "QuiBrescia.it" shkruan se, "marijuana vinte nga Shqipëria nëpërmjet skafistëve. Niseshin me gomonet plot dhe mbërrinin në Kalabri, nga ku korrierët e çonin drogën deri në veri të Italisë". Gjithashtu, burimet nga vendi fqinj pohuan se marijuana pasi mbërrinte në brigjet e Kalabrisë, transportohej drejt Breshias në automjete të modifikuara apostafat për fshehje narkotikësh. Me marjuanë, ky grup furnizonte edhe Holandën. Droga drejt këtij vendi, sipas mediave italiane, trafikohej me avionë. Në rrugë ajrore bëhej edhe transporti i kokainës nga Holanda drejt Italisë. Hetimet për këtë organizatë kriminale nisën vitin e kaluar.



**TRAFIKU NGA VLORA**

Sipas policisë italiane, organizata kriminale ka trafikuar dhjetëra tonelata marijuanë nga Shqipëria. Si bazë kishin një zonë pranë Vlorës, nga ku lënda narkotike nisej me gomone drejt Italisë. Mësohet se marijuana pasi mbërrinte në brigjet e Kalabrisë, transportohej drejt Breshias në automjete të modifikuara apostafat për fshehje narkotikësh.

### HETIMET

Në fund të vitit që shkoi, nëpërmjet përgjimeve karabinierët italianë zbuluan një ngarkesë me kanabis nisur nga Vlora në drejtim të Kalabrisë në jug të Italisë. Dyshohet që droga u transportua nëpërmjet një peshkarexhe e nisur më 26 dhjetor nga Shqipëria dhe u shkarkua tri ditë më vonë. Sasia e drogës së transportuar ishte 2.7 tonë marijuanë e presuar, e cila më pas u sekuestrua më 30 dhjetor në qytetin Artena afër Romës. Ky ishte momenti i arrestimeve të para, ku u prangos edhe një 45-vjeçar shqiptar, që zyrtarisht punonte si mekanik. Ndërkohë, përgjimet kanë vazhduar për të identifikuar të gjithë organizatorët e këtij trafiku. Nga përgjigjet u zbulua se shqiptarët me banim në Breshia porosisnin edhe sasi të konsiderueshme kokainë nga Holanda.

Në krye të kësaj organizate është një shqiptar 35-vjeçar që jeton në Breshia dhe kishte si bashkëpunëtorë më të ngushtë vëllain dhe nipin, tashmë të arrestuar. Sipas policisë italiane, kreu i organizatës, së bashku me vëllain dhe nipin organizonte transportin me makina të modifikuara me dy shasi për fshehjen e kokainës.

## DITA E ÇLIRIMIT

### CEREMONITE

Xhaçka nderon me 'Medaljen e Mirënjohjes', katër ushtarakë që shpëtuan jetë njerëzish

# Rama: Mision i posaçëm, t'i bëjmë të rinjtë të dobishëm për vendin

*Formim ushtarak për ata që s'kanë orientim të qartë arsimor*

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama së bashku me ministren e Mbrojtjes u kanë dorëzuar dje, në Ditën e Çlirimit të Shqipërisë, medalje katër ushtarakëve që kanë vënë jetën në rrezik dhe kanë shpëtuar jetë njerëzish. Në një ceremoni të posaçme, ku i pranishëm ishte edhe ambasadori amerikan Donald Lu e veteranë të luftës e ushtarakë të FASH, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka u shpreh: "Këta ushtarakë nuk kanë luftuar armikun klasik, por kanë vënë veten në rrezik për të shpëtuar jetë njerëzore. Janë profesionistët e thjeshtë, heronjtë pa emër, që gjenden të parët aty ku një jetë njerëzore është në rrezik, ku ngrihet një urë, apo kur refugjatët në ujërat ndërkombëtare kanë nevojë për ndihmë", u shpreh ministrja. Kryeministri Edi Rama në fjalën e tij u shpreh: "Janë të rinjtë shqiptarë, ata që duhet të kujdesen për flakën e kujtimit të Luftës Nacionalçlirimtare, si një pishtar i pazëvendësueshëm në ndriçimin e rrugës së të ardhmes, ku përditë duhet të njohim vetveten si komb, si shoqëri dhe si shtet.

Nuk ka sot një shembull më kuptimplotë e më solid në fushën e jetës shoqërore, sesa shembulli këtyre ushtarakëve. Ishte vërtet prekëse të dëgjoje secilin prej tyre, që pas marrjes së dekoratës, të nderonin ministren e Mbrojtjes me fjalët: I shërbej Republikës së Shqipërisë!", - u shpreh Kryeministri. "Sot më vjen shumë mirë të them se Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut nuk e kemi parë si një vit për t'u kthyer pas, si një vit për t'u rënë daulleve të nacionalizmave të së shkuarës, si një vit për të rrahur gjoksin për bëmat e atyre që shkruan emrin në historinë e këtij vendi me gjak apo me penë, por e kemi parë si një vit për të nxitur burimet e energjive më pozitive të kësaj shoqërie dhe posaçërisht si një vit për t'u dhënë mundësinë më të rinjve që të shfrytëzojnë instrumente të rinj për të njohur më shumë vetveten dhe për t'u bërë më të dobishëm për vendin", tha më tej Rama. Kryeministri foli për tërheqjen e të rinjve drejt ushtrisë. "Një mision i posaçëm, të cilin e kemi quajtur 'Rini-talent-mundësi-dinjitet' i është mirëbesuar Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Arsimit. Edhe me asistencën e partnerëve tanë ndërkombëtarë do të mundësojë sigurimin e një formimi etik dhe ushtarak, në formën e një shërbimi të kontraktualizuar në adresë të të rinjve pa orientim të qartë arsimor apo profesional", tha Rama. Ministrja e Mbrojtjes së bashku me kryeministrin u dhanë medaljet ushtarakëve: Saimir Balla, rreshter i Forcës Ajrore, i cili një vit më parë shpëtoi nga përmbytja një fëmijë të sapolindur në Zenishtë të Burrelit; Fatjon Lulja, pjesë e batalionit mbështetës të xheniove që ka kontribuar në ndërtimin e rrugëve dhe urave, duke iu paraprirë pasojave që mund të sjellë izolimi, moti i keq, apo emergjencat; Ervin Todo, rreshteri i cili mori pjesë në operacionin për evakuimi i banorëve të Urës Vajgurore, që rrezikoheshin nga përmbytja si dhe Esmeralda Muratit, infermierja që së bashku me mjeken Aurela Bala ishin pjesë e misionit të anijes 'Oriku', që u vlerësua edhe nga NATO për operacionin e kërkim-shpëtimit në detin Egje, duke shpëtuar mbi 1 mijë jetë emigrantësh.



Kryeministri Edi Rama me ministren e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, dje në Ditën e Çlirimit të Shqipërisë

**DEKLARATA**

"Sot më vjen shumë mirë të them se Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut nuk e kemi parë si një vit për t'u kthyer pas, si një vit për t'u rënë daulleve të nacionalizmave të së shkuarës, si një vit për të rrahur gjoksin për bëmat e atyre që shkruan emrin në historinë e këtij vendi me gjak apo me penë, por e kemi parë si një vit për të nxitur burimet e energjive më pozitive të kësaj shoqërie", tha Rama.


Presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama, kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi dhe kryetari i bashkisë, Erjon Veliaj dje në Varrezat e Dëshmorëve

**Ministri i Jashtëm në Uashington merr mbështetje nga kongresmeni Gaetz**

## Bushati: Duhet angazhim më i madh amerikan për sigurinë në Ballkan

Ministri Bushati kërkon angazhim më të madh amerikan në përballimin e sfidave të sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të vizitës që po zhvillon në SHBA, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga Qendra për Analizat Politike Evropiane (CEPA) me temë "Këndvështrimi i Shqipërisë mbi Sigurinë Rajonale, Energjinë dhe Atlanticizmin në Ballkanin Perëndimor". I ftuar në këtë panel të moderuar nga Janusz Bugajski dhe Peter Doran, ministri Bushati vlerësoi se Ballkani Perëndimor përbën një rajon kompleks sa u takon sfidave të sigurisë, duke renditur një sërë elementësh që kërkojnë vëmendje të shtuar dhe bashkëpunim më të rritur jo vetëm mes vendeve të rajonit, por edhe nga ana e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Duke u ndalur në rolin e Shqipërisë në rajon, ministri Bushati theksoi se Shqipëria ka një interes strategjik afatgjatë për të kontribuar në paqe dhe stabilitetin e rajonit dhe në këtë kontekst ka përdorur të gjitha platformat ndërkombëtare për të promovuar këtë pozicion. Bushati takoi edhe kongresmenin nga Florida, Matt Gaetz, me të cilin diskutoi mbi zhvillimet më të fundit në Shqipëri dhe rajon. Nga ana e tij, kongresmeni Gaetz u shpreh se, "ju keni një mandat të qartë për të qeverisur dhe keni mbështetjen tonë të plotë për reformat shtet-konsoliduese që keni ndërmarrë. SHBA-të janë veçanërisht të interesuara për reformat në fushën e shtetit ligjor dhe potencialin që këto reforma mund të çlirojnë për ekonominë shqiptare", tha Matt Gaetz.



### ISH-ALEATËT

**Balla e Kryemadhi, bashkë në ceremoninë përkujtimore për dëshmorët në Elbasan**

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi dhe kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla kanë hedhur pas krahëve akuzat e fushatës elektorale dhe janë shfaqur dje përkrah njëri-tjetrit në ceremoninë zyrtare të nderimit të dëshmorëve në qytetin e Elbasanit. Si dy kryesues të partive të tyre për këtë qark, Balla e Kryemadhi kanë vendosur kurora me lule në Memorialin e Dëshmorëve në Elbasan. Ka qenë kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, i cili i ka postuar fotot në faqen e tij zyrtare në "FB". "Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, si një prej momenteve më të rëndësishme të historisë sonë, meriton të kujtohet për të shprehur të gjithë mirënjohjen për ata 28 mijë dëshmorë, të cilët dhanë jetën e tyre, me qëllim çlirimin e atdheut duke u bazuar tërësisht në një luftë partizane", shkroi Balla, bashkëngjitur fotove. "Ashtu siç u radhitëm në koalicionin e fitores në vitin 1944, ashtu sot Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s dhe jemi në rrugën e duhur drejt anëtarësimit në BE", u shpreh Balla. Sipas tij, "në këtë 29 Nëntor, lajm i mirë për të gjithë shqiptarët është se shumë shpejt Shqipëria do të hapë negociatat për anëtarësim në BE".

### TAKIMET

**Tritan Shehu, vizitë në Greqi: Marrëdhëniet, në pikë negative**

Deputeti Tritan Shehu zhvilloi këto ditë një vizitë pune në Greqi. Në një postim në rrjetin social "Facebook", Shehu shpjegon se gjatë vizitës është takuar me personalitete të larta të politikës greke për të diskutuar marrëdhëniet dypalëshe. Sipas Shehut, këto marrëdhënie midis dy shteteve vlerësohen si në pikë negative dhe për këtë duhet bashkëpunim. Në këtë vizitë nuk ka lënë pa takuar kreun e Komisionit të Jashtëm të Sigurisë së Parlamentit për të diskutuar problemin e krimit të organizuar dhe trafikut të drogës. "Takime intense me personalitete të politikës greke: Me zëvendësministrin e Jashtëm, z. Amanatidis; kryetarin e Komisionit të Jashtëm dhe të Sigurisë së Parlamentit, Z.Duozi-nas; me nënkryetarin e Nea Demokratia, z. Georgiadis; me Shefin e Marrëdhënieve me Jashtë të Nea Demokratia, z.Koumoutsakos etj.", shprehet Shehu. "Kudo u shpreh dëshira e vullneti i forcimit të marrëdhënieve midis dy vendeve tona, aktualisht në një pikë negative të tyre. Bashkëpunim me partinë simotër në interes të përbashkët partiak dhe të vendeve tona. Mbështetje e Greqisë në rrugën tonë të integrimit e shqetësim e bashkëpunim për gjendjen në Shqipëri, e lidhur kjo kryesisht me drogën e krimin", tha Shehu.

Të majtët nderojnë dëshmorët e rënë për lirinë e vendit, mungon PD

# Dita e Çlirimit, Rama e Meta bashkë në homazhe para memorialit "Nënë Shqipëri"

## LSI e ndarë nga PS, Kryemadhi: Të reflektojmë



Darina Tanushi

Tre krerët e lartë të shtetit, Presidenti Ilir Meta, Kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi dhe Kryeministri Edi Rama nderuan dje, së bashku dëshmorët e vendit, më rastin e 73-vjetorit të çlirimit. Rama, Ruçi, kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj e ministrat kanë pritur për pak momente deri sa t'u bashkohej Meta në Varrezat e Dëshmorëve dhe më pas kanë vijuar sipas protokollit me vendosjen e kurorave me lule dhe përkuljen përpara memorialit "Nënë Shqipëri". Në këtë ceremoni munguan përfaqësuesit e opozitës, të cilët prej vitesh e festojnë Ditën e Çlirimit në 28 Nëntor, bashkë me festën e Pavarësisë. As Rama dhe as Meta nuk folën pas homazheve për mediat, ndërsa më herët në mëngjes secili prej tyre uroi 29 Nëntorit. "Të dashur miq! Sot është dita e mirënjohjes për të gjithë partizanët, dëshmorët e heronjtë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare që sakrifikuan gjithçka për çlirimin e Shqipërisë",-shkroi dje, Meta në rrjetin social. Edhe kryeministri Rama duke njoftuar për aktivitetet që do të ndodhnin në Tiranë gjatë ditës tha se "73-vjetori i Çlirimit të Atdheut është mundësi e rrallë për të reflektuar mbi sensin e angazhimit dhe solidaritetit për të tjerët, për Shqipërinë!"

**LSI**

Ndërkohë, Lëvizja Socialiste për Integrim u shkëput sot, nga opozita me Partinë Demokratike. Por, drejtuesit e kësaj partie nuk iu bashkuan ceremonisë shtetërore, ku ishte edhe Partia Socialiste, por erdhën më pas për të kryer respektin ndaj dëshmorëve të rënë. Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, shoqëruar nga kryetari i Grupit Parlamentar, Petrit Vasili si dhe kryetarja e LRI-së, Floida Kërpaçi zhvilloi homazhet në varrezat e "Dëshmorëve të Kombit". Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi tha se 29 Nëntori është një ditë e shënuar për të gjithë shqiptarët. Kryemadhi duke iu referuar betejës së madhe të popullit shqiptar tha se nuk ka rëndësi numri, por dëshira, përkushtimi, vullneti dhe zemra për të fituar beteja të rëndësishme. "Ne sot nderojmë sakrificën e 28 mijë dëshmorëve, të cilët aspironin për një Shqipëri moderne, aspironin për një Shqipëri të begatë edhe pse jo të gjitha dëshirat e tyre janë të realizuara, motivimi ynë mbetet që këto dëshira dhe këto ëndrra të tyre t'i çojnë më tej brezat e rinj",-tha kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi. "Historia e vjetër e botës, por edhe historia jonë e re tregon edhe njëherë që mjafton të kesh dëshirën dhe përkushtimin në zemër për të arritur atë që do",-tha kryetarja e LSI-së. "Besoj te dëshira, përgjegjësia, reflektimi i secilit nga ne që këto data të shënuara si 28-29 Nëntori të jenë ditë reflektimi për klasën politike shqiptare për të çuar deri në fund amanetin e të gjithë atyre djemve dhe vajzave që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë dhe mbi të gjitha për të krijuar atë Shqipëri të cilën kanë ëndërruar me qindra dhe mijëra vite shqiptarët",-tha ajo.



Kryeministri Edi Rama dje në Varrezat e Dëshmorëve

**ERION VELIAJ**

Nën moton "Rrugëtojmë nën një flamur", Bashkia e Tiranës mblodhi dje në bulevardin e ri, me rastin e festës së Ditës së Pavarësisë, motoristë nga Shqipëria dhe Kosova, të cilët dhuruan një shfaqje për të gjithë të apasionuarit pas mjeteve sportive. Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj theksoi se bashkimi mes njerëzve është më i rëndësishmi dhe nëse shqiptarët bashkëpunojnë, atëherë asgjë nuk mund t'i ndajë ata.

## "Lavdi shqiptarit të madh, Enver Hoxha", nostalgjikët homazhe me foton e "komandantit"

Nostalgjikë të ish-diktatorit Enver Hoxha ishin dje, për të kryer homazhet e rastit në Varrezat e Dëshmorëve. Këtë vit ata janë mbajtur larg në momentin kur aty kanë qenë krerët e lartë të shtetit. Me foto të diktatorit Enver Hoxha dhe me parulla për të ata kanë qëndruar para memorialit "Nënë Shqipëri". "Lavdi Partisë Komuniste shqiptare"; "Lavdi veprës së Enver Hoxhës"; "Rroftë Partia Komuniste Shqiptare" dhe me simbole të tjera të PKSH-së ata kanë parakaluar para mediave, në përpjekje për të nderuar "komandantin" e tyre. Ata janë shfaqur në "Varrezat e Dëshmorëve" pak kohë pas homazheve nga Presidenti Meta dhe kryeministri Rama. Kjo nuk është hera e parë që fotoja e Enver Hoxhës dhe simbolet të komunizmit shfaqen në aktivitete të tilla. "Fuqitë e mëdha imperialiste po cenojnë sigurinë dhe pavarësinë e popujve, prandaj dhe Partia Komuniste i bën thirrje popullit të jetë gati, të mbrojë pavarësinë dhe lirinë e atdheut",-tha Qemal Çiçollari, kryetari i Partisë Komuniste. "Enver Hoxha dhe Partia Komuniste nuk kanë bërë asnjë krim, ndaj populli dhe atdheut",-shprehet Çiçollari. "Po të mos qe Partia Komuniste dhe Enver Hoxha, nuk do të ishte Shqipëria. Enver Hoxha është figura e parë në Atdhe",- shprehen adhuruesit e diktatorit Hoxha.





## Majko: 1 janari, provë se kufiri "jugosllav" me Kosovën do të jetë kufi i BE

Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko deklaroi dje, në një postim në rrjetin social, se shpreson që "1 janari 2018 do të jetë provë se kufiri "jugosllav" midis dy shteteve tona, Kosovës dhe Shqipërisë do të kthehet në një kufi të standardeve të Bashkimit Europian". Ndërsa përkujtoi datën 29 Nëntor të nderim të dëshmorëve të rënë, Majko u shpreh: "Ky 29 nëntor më duket i akullt e tinëzar. Dhe kjo nuk ka të bëj me luftën dhe LANÇ. Lexova që deklarimet e mia për hapjen e kufijve midis Shqipërisë dhe Kosovës për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe te mallrave, janë quajtur si "fishekzjarre". "I kam hedhur poshtë me neveri ata që paralelizonin 29 Nëntorin e Çlirimit të Shqipërisë me atë të Jugosllavisë. Shqiptarët u prenë në besë në Luftën e Dytë. Ndërsa një pjesë luftonin për të çliruar Jugos-llavinë, një pjesë tjetër u masakrua si rishkrim i historisë së vjetër jugosllave në marrëdhëniet me shqiptarët",-tha dje, Majko.



Presidenti rus, Vladimir Putin

## Vladimir Putin, mesazh Metës: Synojmë përparimin e marrëdhënieve ruso-shqiptare

Presidenti rus, Vladimir Putin i ka dërguar një letër Presidentit shqiptar, Ilir Meta me rastin e festës së Pavarësisë së Shqipërisë, duke theksuar se synon përparimin e marrëdhënieve ruso-shqiptare. Putin shkruan se kjo do t'i shërbente paqes dhe stabilitetit në Ballkan. Në mesazhin e tij, Presidenti rus shkruan: "I nderuar zoti President, merrni urimet e mia me rastin e festës kombëtare të Shqipërisë, Ditës së Flamurit. Synojmë përparimin e marrëdhënieve ruso-shqiptare. Kjo sigurisht do të ishte në përputhje me interesat thelbësore të popujve të vendeve tona, dhe do t'i shërbente përforcimit të paqes dhe stabilitetit në Ballkan dhe në të gjithë Evropën. Ju uroj Juve shëndet dhe suksese, ndërsa të gjithë qytetarëve të Shqipërisë u uroj mirëqenie dhe begati!". Mesazhi i Presidentit rus vjen pas mesazheve të shumta që i kanë ardhur gjatë dy ditëve kreut të shtetit edhe nga Presidenti amerikan Donald Trump dhe presidentë të vendeve të ndryshme të Evropë e Botës, me rastin e festave kombëtare të Pavarësisë dhe Çlirimit.

REPUBLIKA E SHQIPERISË
"D R I T A"Sh.a

Rr."Qemal Stafa",P.161/1,Sh.2.Nr.27. Date : 29.11.2017

N J O F T I M

**Drejtuar:** Çdo aksioneri, personi fizik/juridik privat/publik të interesuar.
**Nga:** Likujdatori i shoqerisë "DRITA" sha, NUIS J62006010K, në likujdim e sipër.
**Lënda :** Njoftim publik për kalimin në likujdim të shoqërisë dhe dërgimin e çdo pretendimi pranë likujdatorit.

Me anë të këtij njoftimi ftohet çdo kreditor potencial i shoqerisë "DRITA" sha, NUIS J62006010K, në likjdim e sipër, të depozitojë pretendimet nëse ka, lidhur me prishjen e shoqerisë dhe kalimin e saj në likujdim.

Ky njoftim ështe pasqyruar dhe në faqen e njoftimeve të QKB-së në internet.

Çdo pretendim i mundshëm të dërgohet brënda 30 ditëve nga data e këtij njoftimi te fundit pranëe adresës së likujdatorit të shoqerisë Zyfer Caco, Tiranë Rr. "Qemal Stafa", Pallati 161/1, Shkalla 2, Apartamenti 27, tel: 0692288503

**Likujdatori i shoqerisë "DRITA" sha**
**Zyfer CACO**

# BUXHETI 2018
## PROPOZIMET

Propozimet e opozitës, nga ulja e taksave tek rritja e pagave dhe pensioneve

# Projektbuxheti 2008, skenari i përballjes së PD, sot në Kuvend

## Basha: Betejë kundër projektit mafioz të Ramës

Valentina Madani

Opozita do të kundërshtojë sot projekt buxhetin 2018 për-mes amendimeve që i ka bërë draftit të qeverisë. Partia Demokratike propozoi dje 16 amendamente për buxhetin e vitit të ardhshëm. Duke marrë shkas nga mungesa e investimeve të huaja, demokratët propozojnë ndryshimin e shkallës së tatim-fitimit në masën e 9% nga 15 që është aktualisht, ndërsa kërkojnë konsensus për rikthimin e taksës së sheshtë prej 10 për qind. Gjithashtu, opozita propozon uljen e TVSH-së në masën e 15%, teksa kërkon që pragu për biznesin e vogël të jetë 12 mln lekë. Duke theksuar se taksa progresive rëndon shtresën e mesme dhe rrogëtarët, demokratët kërkojnë që kjo nga kjo taksë të përjashtohen pagat deri në 35.000, mbi këtë prag, opozita propozon taksim në masën e 9 %. Një tjetër propozim i Partisë Demokratike ka të bëjë me koncesionet, duke kërkuar që ato të regjistrohen si borxh publik, PD propozon që tavani për vlerën totale të kontratave koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara për vitin 2018, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve, të jetë 40.1% e PBB-së. Teksa kërkon uljen e taksës së qarkullimit, opozita kërkon gjithashtu që buxheti për arsimin të jetë 5%, ndërsa pensionistët të marrin një shpërblim sa gjysma e pensionit të tyre.

**DEKLARATA**

Kreu i PD-së, Lulzim Basha paralajmëroi betejë në seancën e sotme plenare kundër atij që e quan buxhet mafioz të Edi Ramës. Kreu i demokratëve tha pas mbledhjes së grupit parlamentar se opozita është e vendosur të frenojë projektin kriminal të pastrimit të parave të pista. "Blloku i parave që do u çohet si patë e pjekur oligarkëve dhe karteleve të krimit për të pastruar paratë e drogës përmes skemës së koncesioneve, që u kushton qindra milionë euro shqiptarëve dhe skemës së parave të pista PP 1 miliardësh të zhbëhet. Këto para të shkojnë aty ku Shqipëria ka më shumë nevojë", tha z.Basha. Sipas tij, 16 amendamentet e PD-së do të ulin barrën fiskale për shqiptarët. "Duke propozuar taksën e sheshtë 9%, TVSH 15%, pragu për TVSH e biznesit të vogël 12 milionë lekë në vit. Qëndrimi i PD-së ka qenë dhe mbetet i vendosur kundër këtij projektbuxheti, që duhet të jetë akti i fundit i kësaj qeverie që ne nuk do ta lëmë të miratohet. Pjesë e këtij qëndrimi do të jetë edhe dita e nesërme në parlament. Ne do të paraqesim amendamente në Kuvend, të cilat synojnë në radhë të parë të zhbëjnë sistemin kriminal të taksave që është propozuar këto 4 vite", tha z.Basha.



Kryetari i PD-së, Lulzim Basha

**PAGAT**

PD kërkon heqjen e taksës së qarkullimit, që sipas opozitës, çon në uljen e çmimit të karburantit me 20 lekë për litër. Rritja me 20% e fondit të ndihmës ekonomike, rritja e pagave dhe pensioneve, subvencione për fermerët, si dhe libra falas për nxënësit deri në klasën e 9 janë disa nga propozimet e demokratëve.

**DOSJA**

Kreu i PD-së paralajmëroi dje publikimin e dosjes së radhës, që ka të bëjë me skandalet e qeverisë. Z.Basha tha se materiali që disponon PD po analizohet për besueshmërinë dhe po analizohen provat. "Një gjë është e sigurt, gjithçka që na vjen në vëmendje dhe verifikohet se ka besueshmëri, hapi i parë është t'u bëhet publik qytetarëve përmes mediave".

### PD, 16 AMENDAMENTET, NGA KONCESIONET TEK ULJA E TAKSËS PËR QARKULLIMIN DHE TVSH-së

■ **Amendament për ndryshimin e shkallës së tatim- fitimit në 9% (Edmond Spaho)**
Raportet ndërkombëtare tregojnë se Shqipëria ka taksa të larta. Barra fiskale në Shqipëri është 37% dhe ky është një nga shkaqet e largimit të investitorëve të huaj. Dhoma e Tregtisë Shqiptaro-Britanike u kërkoi deputetëve me një letër pak ditë më parë të gjenin konsensus për rikthimin e taksës së sheshtë 10%. PD propozon uljen e normës së tatimit në 9% nga 15% që është aktualisht. Kjo masë lehtëson bizneset, redukton informalitetin, nxit zhvillimin ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës, krijon kushte për nxitjen e investimeve të huaja, si dhe përmirëson nivelin e jetesës së shqiptarëve.

■ Amendament për uljen e TVSH-së 15% dhe pragu i TVSH-së 12 milionë lekë (Nadire Meçorapaj)
Të ardhurat nga TVSH janë ulur këto vite kryesisht për shkak të informalitetit dhe rënies së konsumit. Propozohet rishikimi i normës tatimore të TVSH-së nga 20%, në 15%. Ulja e TVSH-së dhe ulja e pragut në 12 milionë për biznesin e vogël do të japë një efekt të menjëhershëm në rritjen e konsumit dhe do të ndikojë në uljen e informalitetit, i cili nuk zgjidhet duke e goditur biznesin, por duke e lehtësuar atë.

■ **Amendament për uljen e tatimit mbi të ardhurat personale (Fatbardha Kadiu)**
Të ardhurat që vijnë nga paga zënë rreth 60% të strukturës së tatimit mbi të ardhurat personale. Kjo tregon se politika e qeverisë për taksën progresive rëndon më shumë tek shtresa e mesme dhe rrogëtarët. Prandaj propozohet përjashtimi nga ky sistem taksimi për të gjitha pagat nën 35.000 lekë dhe ulja e normës e tatimit në 9 (nëntë) për qind për të gjithë pagat mbi 35.000 lekë.

■ **Amendament për regjistrimin e koncesioneve në borxhin publik (Jorida Tabaku)**
FMN kritikoi vendimin e qeverisë për të kryer investime publike nëpërmjet PPV-ve dhe tha se, "kjo paraqet rreziqe të konsiderueshme fiskale". FMN theksoi se, "duhet të reflektohet me transparencë ndikimi që kanë PPP-të në llogaritë fiskale dhe borxhin publik". Fshehja e këtij borxhi nga letrat e buxhetit është një tentativë për të maskuar realitetin e borxhit në vend, që në pak vite do të rritet me 7%. Prandaj propozohet që tavani për vlerën totale të kontratave koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara për vitin 2018, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve të jetë 40.1% e PBB-së.

■ **Amendament për uljen e taksës së qarkullimit (Edmond Spaho)**
Për shkak të ndryshimit të taksës së qarkullimit në 2014-ën, të dhënat e GIZ tregojnë se shqiptarët e blenë karburantin më çmim thuajse të njëjtë me qytetarët e Austrisë dhe Gjermanisë. Për uljen e ndjeshme të çmimit propozohet që taksa e qarkullimit për benzinën dhe gazolin të jetë 7 lekë/litri. Kjo e ul çmimin me 24 lekë/për litër.

■ **Amendament për rritjen e pagave (Bardh Spahia)**
Në programin e qeverisë dhe sipas pohimeve të Edi Ramës, nuk është parashikuar rritje pagash, pavarësisht normës së inflacionit. Që rritja e pagave të mos mbetet një akt elektoral i qeverisë, siç ndodhi këtë vit, propozohet që në buxhet të ketë një fond të posaçëm prej 2,000 milionë lekësh për rritjen e pagave të punonjësve të administratës shtetërore, për të shmangur pasojat e inflacionit.

■ **Amendament për shpërblimin me gjysmën e pensionit për pensionistët (Bardh Spahia)**
Kryeministri premtoi shpërblimin e fundvitit për pensionistët, por nuk e mbajti premtimin e tij. Për të sjellë në vëmendje këtë fakt dhe për t'u ardhur në ndihmë pensionistëve propozohet ndryshimi i projektbuxhetit dhe dhënia e shpërblimit të fundvitit për pensionistët në masën e gjysmës së vlerës së pensionit mujor.

■ Amendament për arsimin, 5% (Bardh Spahia)
Investimet e qeverisë "Rama" për arsimin janë në rënie të përvitshme. Këtë vit është 2.34% e PBB dhe sipas parashikimeve të kësaj qeverie, do të vazhdojë të ulet në 2020 në 2.1%. PD në programin e vet ekonomik dhe me këtë amendament e barazon investimin në arsim me standardet e vendeve të OECD, 5% e PBB.

■ **Amendament për rritjen e subvencioneve në bujqësi (Edmond Spaho)**
Qeveria premtoi në fushatë rritjen e subvencioneve për bujqësinë, por skema e qeverisë për financimin nuk shkon tek fermeri. Atë e përfiton grosisti. Për t'u ardhur në ndihmë direkte fermerëve nëpërmjet programit "Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor", propozohet rritja me 1 miliard lekë e fondit prej 5.2 miliardësh.

■ **Amendament për tekstet falas në arsimin e detyrueshëm (Albana Vokshi)**
Raportet e Bankës Botërore thonë se varfëria dhe varfëria ekstreme është rritur në Shqipëri. Kjo ka ndikuar në përhapjen e fenomenit të braktisjes shkollore. Prandaj propozohet dhënia e teksteve mësimore dhe atyre ndihmëse duke u mbështetur nga një fond prej 1.16 miliardë lekë, rreth 8.5 milionë euro.

■ **Amendament për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë (Jorida Tabaku)**
Shteti u detyrohet ish-të përndjekurve rreth 32.5 miliardë lekë të reja dhe sipas KLSH-ë, duhen 16 vjet për të shlyer detyrimet. Pavarësisht propagandës, gjatë 2009-2013 janë dëmshpërblyer më shumë se gjatë 2014-2017. KLSH thotë se qeveria i ka mundësitë për të rritur fondet. Propozimi i PD është rritje me 2.5 miliardë leke për vitin 2018.

■ **Amendament për mbështetjen e shtresave në nevojë (Bardh Spahiu**)
Rritja e taksave, e çmimit të energjisë dhe e çmimeve në përgjithësi, si dhe taksat e reja të 2018-ës prekin të parët qytetarët në nevojë. Për të zbutur efektin e rritjes së taksave dhe kostos së jetesës propozohet që fondi për kompensimin e shtresave në nevojë të rritet me të paktën 20%.

■ **Amendament për rritjen e buxhetit për rininë (Romeo Gurakuqi)**
Qeveria e ka ulur në minimum mbështetjen për rininë, edhe pse niveli i papunësisë së saj është shumë i lartë. Qeveria ka programuar 1/10 e fondeve të viteve paraardhëse, prandaj opozita kërkon dhjetëfishimin e buxhetit, duke çuar në 700 milionë shpenzimet e ministrisë përkatëse dhe detajimin e tyre.

■ **Amendament për rritjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë (Romeo Gurakuqi)**
Qeveria ka parashikuar një formulë të re për financimin e bashkive për vitin 2018. Kjo formulë nuk merr parasysh disa tregues që lidhen me varfërinë dhe pabarazinë, që do të thotë më pak investime dhe shërbime vendore për qytetarë. Prandaj propozohet që transferta e pakushtëzuar të rritet me të paktën me 0,3% të PBB, ose me 5 miliardë lekë. Kjo do të siguronte vijimin normal të punës në bashkitë e vendit.

■ **Amendament për mësuesin ndihmës (Luan Baçi)**
Në Shqipëri jo të gjitha fëmijët përfitojnë nga e drejta kushtetuese për arsimin falas. Gjatë këtyre 4 viteve ka pasur rritje të ndjeshme të fëmijëve me aftësi të kufizuar, atyre të ngujuar në gjakmarrje dhe të shtresave në nevojë, që nuk arrijnë të shkojnë në shkollat nëntëvjeçare. Statistikat e Ministrisë së Arsimit tregojnë se raporti mes mësuesve ndihmës dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara është 1 me 11, i pamjaftueshëm për nevojat e kësaj kategorie të veçantë. Ky problem është pjesë e arsimit parauniversitar, por nuk është vënë në zbatim nga qeveria "Rama". Propozohet rritja e buxhetit me 3.9 mln lekë për trefishimin e mësuesve në dispozicion të shkollimit të fëmijëve me kushte të vështira, si dhe ngritja e infrastrukturë së përshtatshme për këta mësues.

■ **Amendament për rritjen e buxhetit të kulturës (Valentina Duka)**
Qeveria ka parashikuar për kulturën 0,4 % të PBB, buxheti më i ulët në rajon dhe në Europë. 69% e këtij buxheti shkon për rroga dhe shpenzime të tjera. Pjesa e mbetur është fare e pamjaftueshme për projekte të mirëfillta kulturore. Propozohet dyfishimi i buxhetit.

**BUXHETI**

## Sot votohet, skemat të propozuara nga PS e LSI

Deputetët sot në Kuvend do të marrin në shqyrtim tri projekte për ndryshimin e buxhetit dhe të paketës fiskale. Komisioni i Ekonomisë në mbledhjen e fundit miratoi disa shtesa të fondeve të institucioneve, ndërsa shkurtoi fondet e infrastrukturës me rreth 400 mln lekë. Në seancë do të propozohen 26 milionë lekë shtesë për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, 15 milionë lekë për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe 33.8 milionë lekë për Shkollën e Magjistraturës. Për Ministrinë e Ekonomisë do të kërkohen 270 milionë lekë më shumë, ndërsa SHISH 275 milionë lekë shtesë, për Presidencën 30 milionë lekë dhe për Kuvendin 14 milion lekë. LSI ka tri amendime, të cilat u rrëzuan në Komisionin e Ekonomisë. LSI kërkon amendim për tri çështje, siç është ulja TVSH-së për ushqimet bazë të shportës nga 20% në 5%. Përjashtim nga TVSH-ja për biznesin e vogël me xhiro vjetore deri në 5 milionë lekë si dhe heqjen e taksës për shtëpinë e parë. Do të jetë votimi në parlament, që do i vendosë vulën përfundimtare buxhetit të shtetit dhe paketës fiskale 2018.

## Buxheti, Balla: Basha ngatërron partinë

Pas publikimit të amendamenteve nga PD, ku kërkohen ndryshime në buxhet, reagoi kreu i deputetëve të PS-së, Taulant Balla. Në cilësinë e kreut të grupit parlamentar në PS, Balla i thotë Bashës që të mos ngatërrojë partinë kot me këto amendamente. Balla në statusin e tij në rrjete sociale deklaron se Basha nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e buxhetit. "Lulzim Basha, pasi e ka ngatërruar Partinë Demokratike në një skemë të pastër pastrimi parash me kompani off-shore, sot e ngatërroi përsëri partinë në një lojë qesharake amendamentesh të buxhetit 2018. Gjatë javëve që buxheti shqyrtohej në komision apo kur buxheti u votua në parim në seancë", tha z.Balla.

Raporti u referohet të dhënave të FMN, Bankës Botërore dhe institucioneve statistikore

# Shqipëria ka pagën më të ulët mesatare në Europë

## *INSTAT: Paga mesatare mujore, vetëm 290 euro*

Ornela Manjani


INSTAT

Paga mesatare mujore neto në Shqipëri arrin deri në 290 euro. Kjo është paga mesatare më ulët në të gjithë Europën. Sipas të dhënave të përpunuara nga Wikipedia, bazuar në informacionet e marra nga FMN, Banka Botërore dhe institucionet përkatëse statistikore vendase, në Shqipëri, paga mesatare neto (pas taksave) është 347 euro në muaj, sipas të dhënave që janë përditësuar në tremujorin e parë 2017. Në këtë nivel, paga mesatare është më e ulëta në Europë, me përjashtim të Bjellorusisë, Moldavisë dhe Ukrainës. Wikipedia i referohet të dhënave të INSTAT për pagën mesatare në sektorin shtetëror, që ishte 56,500 lekë në fund të tremujorit të parë, ndërsa të dhënat e tjera të INSTAT tregojnë se paga reale në ekonomi, përfshirë edhe sektorin privat, është akoma më e ulët.

**PAGA MESATARE**

Sipas INSTAT, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas group-profesioneve dhe gjinisë në fund të vitit 2016 ishte 45,845 lekë, pra rreth 334 euro bruto dhe 290 euro neto. Këtu ka ndikim edhe fakti që informaliteti i pagës në sektorin privat është shumë i lartë dhe një numër i madh subjektesh nuk deklarojnë pagën reale për të punësuarit e tyre(shënim i Monitor). Në krahasim me një vit më parë, paga mesatare në ekonomi ra me 2.1% në vitin 2016. Në Kosovë, paga mesatare neto është më e lartë se në Shqipëri, ajo luhatet në rreth 405 euro. Në rajon, sipas Wikipedia, pagën mesatare më të lartë e ka Mali i Zi, me 509 euro në muaj, e ndjekur nga Bosnjë Hercegovina me 439 euro, Bullgaria me 423 euro, Serbia 407 euro, Kosova 405 euro dhe Maqedonia 372 euro.

**FUQIA BLERËSE**

Edhe e matur sipas metodës së fuqisë blerëse, ku të ardhurat përshtaten me shpenzimet e jetesës, paga në Shqipëri është sërish më e ulëta në Europë, me rreth 1000 dollarë. Madje në këtë renditje, Shqipërisë ia kalon edhe Bjellorusia, që ka pagë mesatare më të ulët sesa ne. Më të lartë pagën, sipas fuqisë blerëse, e kanë Mali i Zi, që me 1422 dollarë ia kalon edhe Portugalisë, Bullgarisë dhe Rumanisë dhe Kosova (1251), që ia kalon dhe Serbisë e Bosnjës. Në të dy këto shtete, kosto reale e jetesës është më e lirë, rroga është më e mjaftueshme për të blerë produkte të ndryshme, në krahasim me Shqipërinë, apo shtete të tjera të rajonit. Në Europë, vendi ku ke mundësi të marrësh më shumë të ardhura përmes pagës është Zvicra me 4,421 euro në muaj, të ndjekura nga Islanda me 3,430 euro, Norvegjia (3,405), Danimarka (3,270), Luksemburgu (3,159), Suedia (2,713).

**INSTAT**

Paga mesatare është më e ulëta në Europë, me përjashtim të Bjellorusisë, Moldavisë dhe Ukrainës. "Wikipedia" i referohet të dhënave të INSTAT për pagën mesatare në sektorin shtetëror, që ishte 56,500 lekë në fund të tremujorit të parë.

**Paga mesatare mujore neto në shtetet europiane**

| Renditja | Shteti | Paga neto në Euro | Paga neto në USD, sipas fuqisë blerëse (PPP) |
|---|---|---|---|
| 1 | Zvicra | 4,421 | 3,991 |
| 2 | Islanda | 3,430 | 2,904 |
| 3 | Norvegjia | 3,405 | 3,634 |
| 4 | Danimarka | 3,270 | 3,242 |
| 5 | Luksemburgu | 3,159 | 3,553 |
| 6 | Suedia | 2,713 | 2,989 |
| 7 | Finlanda | 2,509 | 2,704 |
| 8 | Irlanda | 2,479 | 3,076 |
| 9 | Gjermani | 2,270 | 2,914 |
| 10 | Franca | 2,225 | 2,767 |
| 11 | Holanda | 2,155 | 2,724 |
| 12 | Mbretëria e Bashkuar | 1,980 | 2,525 |
| 13 | Austria | 1,934 | 2,316 |
| 14 | Belgjika | 1,920 | 2,333 |
| 15 | Italia | 1,758 | 2,329 |
| 16 | Spanja | 1,749 | 2,619 |
| 17 | Qipro | 1,658 | 2,787 |
| 18 | Sllovenia | 1,051 | 1,776 |
| 19 | Estonia | 993 | 1,751 |
| 20 | Greqia | 917 | 1,523 |
| 21 | Republika Çeke | 870 | 1,670 |
| 22 | Portugalia | 846 | 1,380 |
| 23 | Kroacia | 800 | 1,697 |
| 24 | Polonia | 770 | 1,848 |
| 25 | Sllovakia | 722 | 1,516 |
| 26 | Letonia | 691 | 1,396 |
| 27 | Lituania | 660 | 1,465 |
| 28 | Hungaria | 654 | 1,564 |
| 29 | Rumania | 517 | 1,385 |
| 30 | Mali I Zi | 509 | 1,422 |
| 31 | Bosnjë Hercegovina | 439 | 1,237 |
| 32 | Bullgaria | 423 | 1,281 |
| 33 | Serbia | 407 | 1,201 |
| 34 | Kosova | 405 | 1,251 |
| 35 | Maqedonia | 372 | 1,233 |
| 36 | ***Shqipëria*** | ***347*** | ***1,023*** |
| 37 | Bjellorusia | 320 | 1,216 |
| 38 | Moldavia | 216 | 600 |
| 39 | Ukrainë | 190 | 800 |

*Burimi: Wikipedia, INSTAT*

**Raporti i BERZH për 10 vendet e rajonit**

## 'Shqipëria të përmirësojë shërbimin në administratë'



Qeverisja e mirë dhe konkurrenca në treg janë dy treguesit më të dobët që ka Shqipëria në renditjen që bën raporti i Tranzicionit i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. BERZH rekomandon që vendi ynë të ndërmarrë politika më fleksibël për të stimuluar lirinë e tregut dhe për të përmirësuar shërbimet në administratë. Mes 10 vendeve të rajonit, Shqipëria qëndron e shtata në indeksin e këtyre treguesve, duke lënë pas vetëm Bosnjë Hercegovinën dhe Kosovën. Tjetër pengesë në të bërit biznes në Shqipëri, BERZH sheh edhe aksesin e ndërmarrjeve në rrjetin e energjisë elektrike. "Mjaft firma në Shqipëri, Egjipt, Kosovë, Liban dhe Taxhikistan raportojnë humbje nga 2 deri në 7% të prodhimit të tyre për shkak të ndërprerjeve të energjisë. Këto norma janë një barrë të konsiderueshme",-thuhet në raportin e Trazicionit. BERZH rekomandon që Shqipëria të vazhdojë investimet në projektet e rrugës, por sidomos në sektorin e energjisë në mënyrë që të arrijë vendet e zhvilluara. Vendit tonë i nevojiten afro 1.2 miliardë euro investime në të dy sektorët. Megjithatë BERZH merr si një shembull pozitiv legjislacionin që ka bërë Shqipëria sa i përket studimeve në projektet partneritet publik-privat. "Shqipëria për shembull, ka një legjislacion të hollësishëm për PPP-të ku kërkohet që autoritet kontraktore të vlerësojnë veprat që në fazën përgatitore. Por efektiviteti i këtyre masave mbetet për t'u parë dhe do të varet shumë edhe nga zbatimi në praktikë"- përfundon BERZH.

**Të ardhurat nga akciza në 10 muaj**

## Arkëtohen 2.9 miliardë lekë më shumë se në vitin 2016



Niveli i importit të produkteve, sidomos atyre për të cilat paguhet akcizë, është rritur gjatë këtij viti duke shënuar dhe arkëtim në nivele më të larta të të ardhurave në buxhetin e shtetit. Mallrat për të cilat paguhet akcizë janë karburantet, cigaret, alkooli, kafeja dhe birra. Referuar të dhënave zyrtare të Ministrisë së Financave, rezulton se të ardhurat në buxhetin e shtetit gjatë 10- mujorit të këtij vitit kanë qenë më të larta se një vit më parë. Kështu të ardhurat nga akciza janë realizuar në vlerën 37.4 miliardë lekë, ose 2.9 miliardë lekë më shumë se 10-mujori i vitit 2016, periudhë që kapi vlerën e 34.5 miliardë lekë. Sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të gjithë zërat ose mallrat që tatohen me akcizë gjatë kësaj periudhe janë me rritje. Të ardhurat nga taksa e akcizës në vitin që lamë pas shënuan një mosrealizim të ndjeshëm. Ndërkohë që në fillim të këtij viti qeveria përfshiu për herë të parë në sistemin e akcizës edhe gazin e lëngshëm, si një mundësi për të rregulluar tregun, por pse jo edhe për të rritur të ardhurat në buxhet. Por duke parë rritjen e importit të mallrave mund të ketë ndikuar rritja e konsumit, dhe e dyta aksioni ndaj informalitetit mund të ketë ndikuar në uljen e evazionit dhe kontrabandës në këtë sektor. Por duke qenë se jemi në fazën përmbyllëse të paketës fiskale për vitin e ardhshëm, për nivelin e akcizës ka dy propozime. E para është rritja e këtij niveli për cigaret, dhe e dyta heqja e kësaj takse për pijet energjike.









Gjatë aktivitetit sensibilizues kundër dhunës me bazë gjinore

Anëtarja e Komitetit të Grave: Nuk kanë kurajë të denoncojnë, ngacmime edhe në vendet e punës

# E frikshme, çdo muaj 1 grua humb jetën nga dhuna

## *Arjola Alika: Në 6 muaj janë shënuar 3000 raste keqtrajtimi*

Voltiza Duro

Sipas statistikave, çdo muaj një femër humb jetën si pasojë e dhunës në familje, ndërsa çdo ditë 12 femra e denoncojnë atë. Në 6-mujorin e parë të 2017-ës janë evidentuar rreth 3 mijë raste dhune, ndërkohë gjykatat kanë lëshuar rreth 1600 urdhra mbrojtjeje për këto femra. Në kuadër të ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, rreth 150 anëtarë të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë organizuan aktivitetin sensibilizues ku mbështetën fushatën e ITUC "Stop Dhunës me Bazë Gjinore në Punë - Mbështetja e një Konvente të ILO-s". Asambleja e BSP-SH votoi njëzëri për të ndërmarrë veprime konkrete në eliminimin e dhunës me bazë gjinore përmes marrëveshjeve kolektive. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Arjola Alika, anëtare e Komitetit të Grave për Këshillin Rajonal Europian, PERC, njëkohësisht dhe përfaqësuese e BSPSH-së tregon se në bazë të statistikave, shifrat e dhunës ndaj femrave në vendin tonë janë të frikshme.

**Si paraqiten shifrat e dhunës ndaj femrave në Shqipëri?**

Në bazë të të dhënave që kemi arritur të sigurojmë në komisariate dhe gjykata, statistikat në Shqipëri janë të frikshme. Çdo muaj një femër humb jetën nga dhuna në familje, ndërsa çdo ditë plot 12 femra denoncojnë dhunën. Në 6-të mujorin e parë të vitit 2017-të janë evidentuar 2968 raste dhune e gjykatat kanë lëshuar plot 1563 urdhra mbrojtjeje për të dhunuarat. Gjithashtu, vlen të theksoj se të paktën 2 persona ne ditë arrestohen për dhunë të ushtruar në familje.

**Sa denoncohen rastet e dhunës në vendin tonë dhe a ndihen të frikësuara viktimat?**

Sipas statistikave, një pjesë e madhe e femrave në vendin tonë nuk i denoncojnë rastet e dhunës, si në familje, si dhe në vendin e punës. Faktori kryesor i mosdenoncimit është frika nga dhunuesi apo dhe nga opinion. Faktorë të tjerë që i stepin janë humbja e besimit në organet e gjyqësorit në Shqipëri, për shkak të dënimeve të ulëta që marrin dhunuesit, si dhe për shkak të pamundësive financiare e mosnjohjes së legjislacionit. Të gjitha këto kanë bërë që të rishihet legjislacioni shqiptar dhe një nismë e fundit e Ministrisë së Drejtësisë është për humbjen e të drejtës së kujdestarisë së fëmijëve për dhunuesin, si dhe mospërfitimi nga amnistia, nëse është i dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale të dhunës në familje.



Arjola Alika, anëtare e Komitetit të Grave për Këshillin Rajonal Europian

**A ka raste dhune në vendet e punës dhe në cilat forma paraqitet ajo?**

Sipas studimeve të kryera nga ITUC dhe ETUC, dhuna në familje është e lidhur me dhunën në vendin e punës. Nuk janë të pakta rastet kur dhuna fizike, psikologjike apo ngacmimet seksuale ekzistojnë dhe në vendin e punës, për të cilin nuk ka statistika, pasi punonjësit kanë frikë se humbasin vendin e punës në rast se bëjnë një denoncim.

**Ku mund të drejtohen femrat e dhunuara?**

Femrat e dhunuara fillimisht duhet të vrasin frikën dhe të denoncojnë çdo rast dhune në familje pranë komisariatit të policisë në zonën ku banojnë. Ndërsa për rastet e dhunës në punë, mund të drejtohen pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës. Edhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, pra BSPSH, ofron asistencë ligjore falas për punonjësit apo punonjëset e dhunuara në vendin e punës.

**Sa prej tyre marrin zgjidhje pas denoncimit?**

Për shkak të moszbatimit të legjislacionit, ka ende shumë probleme për t'u dhënë një zgjidhje përfundimtare femrave të dhunuara, që marrin guximin të denoncojnë rastet. Por kam besimin se nismat e fundit që do të merren nga Ministria e Drejtësisë do të ndikojnë në ashpërsimin e ligjit, ashpërsimin e dënimeve dhe në funksionimin e shtetit të së drejtës.

**Çfarë opsionesh ofroni ju për minimizimin e këtij fenomeni?**

BSPSH do të luftojë për rivendosjen e dinjitetit të grave dhe për të mos kursyer asnjë përpjekje në luftën për të parandaluar, menaxhuar dhe eliminuar ngacmimet në vendin e punës dhe dhunën kundër grave. Ne angazhohemi për të rritur përpjekjet tona për të eliminuar dhunën me bazë gjinore përmes programeve dhe fushatave në vendin e punës. Së pari, duhet t'i kushtojmë vëmendje të veçantë në mbështetjen e Konventës dhe Rekomandimit të propozuar të ILO-s kundër dhunës dhe ngacmimeve në botën e punës. Së dyti, duhet të krijojmë, zhvillojmë e forcojmë mekanizmat e shoqatave sindikale për t'u kushtuar vëmendje grave viktima të dhunës. Po kështu, të zhvillohen veprime për të identifikuar dhe diagnostikuar lloje të ndryshme të dhunës nëpërmjet bashkëpunimit midis sindikatave, Inspektoratit Shtetëror të Punës, shoqërisë civile, medias etj.

**Cilat janë disa nga aktivitetet sensibilizuese të organizuara prej jush kundër dhunës me bazë gjinore?**

Unë si përfaqësuese e BSPSH, mora pjesë në Konferencën e 3-të të Grave të ITUC, më 9-13 tetor 2017, ku mbi 120 delegatë nga gjithë bota u mblodhën në Kosta Rika për të vlerësuar gjendjen e grave punëtore në botë. Deklarata e BSPSH si dhe sindikatave të Belgjikës, CSC, FGTB, CGSLB, organizatat partnere dhe ITUC/TUCA në Konferencën e 3-të ITUC të Grave kishte në fokus eliminimin e dhunës dhe ngacmimeve me bazë gjinore në botën e punës. BSPSH ka iniciuar fushata të mbështetura nga ITUC, PERC dhe ETUC si "Kundër Dhunës me bazë gjinore në vendin e Punës; Mbështet një Konventë të ILO-s" si dhe "I sigurt në shtëpi, i sigurt në punë".

### ZHULJETA HARASANI

### Miliona gra përballen me dhunën e ngacmimet në jetë dhe punë

Koordinatorja Kombëtare e ILO-s në Shqipëri, Zhul jeta Harasani, e pranishme në këtë aktivitet, theksoi edhe njëherë mesazhin e drejtorit të përgjithshëm të ILO-s, Guy Ryder mbi dhunën në vendet e punës. "Mesazhet e fundme të fushatave globale janë një kujtesë e fortë për të gjithë se miliona gra përballen me dhunën dhe ngacmimet në jetën e tyre dhe gjatë punës - kur ato marrin çeqet e tyre të pagave, kur përpiqen të avancojnë karrierën e tyre ose thjesht ndërsa përpiqen të ushqejnë familjet e tyre. Sot, duhet të përqendrohemi në atë që bota e punës mund dhe duhet të bëjë për t'i dhënë fund dhunës dhe ngacmimit ndaj të gjithë punëtorëve", - u shpreh Harasani gjatë takimit.






## ILO: Alarmi për Shqipërinë, hapa mbrapa nga 2010-ta

# Vetëm 6.9% e të papunëve marrin asistencë

Në vendin tonë vetëm 6.9% e të papunëve përfitojnë asistencë monetare, çka e rendit Shqipërinë shumë larg shteteve të mirëqenies sociale. Këto të dhëna vijnë nga studimi më i fundit i Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ILO, e cila flet për një situatë alarmante në krahasim me vendet e tjera të botës. Shifrat tregojnë se në Shqipëri vetëm një në 15 të papunë përfiton asistencë duke u renditur kështu e 12-ta nga fundi në listën botërore. Ndërsa në Europë, më keq se vendi jonë, paraqitet Bosnjë-Hercegovina dhe Turqia. Brenda 7 vitesh, situata në lidhje me asistencën për të papunët në Shqipëri, paraqitet më keq, kjo pasi ka një ulje të ndjeshme të normës me mbi 3%. Në vitin 2010, norma ishte 10.2% çka tregon se vendi ynë jo vetëm që nuk ka bërë hapa para për t`iu afruar standardeve europiane, por është larguar edhe më tej nga këto standarde. Pra, Shqipëria vazhdon të mbetet larg shteteve të mirëqenies sociale pasi shifra 6.9% e të papunëve që përfitojnë asistencë, jo vetëm që është larg 100%, që në vendet më të zhvilluara të botës, dhe kryesisht në Europën veriore janë një standard më se normal, por e vendos Shqipërinë ndër vendet e fundit në listë në Europë dhe Azinë Qendrore.

## QKEV: Sot afati i fundit i regjistrimit, dokumentacioni që nevojitet

# Provim certifikimi për mjekët që s'kanë përmbushur detyrimet

## *Shpallen datat sipas specialiteteve*

Voltiza Duro

Brenda ditës së sotme, të gjithë mjekët që nuk kanë përmbushur detyrimet e ciklit të parë të certifikimit 2010-2014, sipas specialiteteve përkatëse, duhet të paraqiten pranë QKEV për t'u regjistruar në provim. Njoftimi është publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, e cila ka shpallur datat e provimit të certifikimit, bazuar në fushat përkatëse. "Regjistrimet për provim bëhen pranë QKEV-së deri më datë 30 nëntor 2017, duke paraqitur dokumentet: fotokopje të kartës së identitetit; fotokopje e lejes së ushtrimit të profesionit."-citon QKEV. Ditën e testimit, pjesëmarrësit duhet të jenë të pajisur me mjetin e identifikimit, të kenë faturën e pagesës për provimin e certifikimit dhe të paraqiten të paktën 30 minuta para provimit. "Më datat 7,8,12,13,14 dhjetor 2017, ora 9:00 në Fakultetin e Mjekësisë zhvillohet provimi i certifikimit për mjekët, të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet e ciklit të parë të certifikimit 2010-2014,sipas specialiteteve përkatëse."-thuhet në njoftim. Respektivisht, më datën 7 dhjetor do të zhvillohet provimi në degët Anestezi Reanimacion, Endokrinologji, Hematologji, Biokimi, Sëmundje infektive, Urologji, dhe Obstetrike Gjinekologji. Një ditë më pas do të kryhet testimi në specialitetet Mjekësi familje, Kirurgji, Onkologji, Ortopedi, ORL, Nefrologji, e Neurologji. Ndërsa më 12 dhjetor të gjithë të specializuarit në fushat Neurokirurgji, Okulistike, Gastrihepatologji, Alergologji, Pediatri, Imazheri, dhe Psikiatri do i nënshtrohen testimit. Më tej, një ditë më pas do të zhvillohet provimi në specialitetet Reumatologji, Kardiologji, Pneumologji, Mikrobiologji, Anatomi patologjike dhe Mjekësi ligjore, Shëndet publik, e Urgjenca mjekësore. Dita e fundit e testimit për mjekët, do të jetë 14 dhjetori i këtij viti në degët Imunologji, Dermatologji, Toksikologji, Hipertoni dhe mjekësi interne.

### VLERËSIMI I PROVIMIT

Provimi i certifikimit kryhet për të vlerësuar nivelin e njohurive dhe kompetencave të profesionistëve që nuk janë angazhuar plotësisht në edukimin e tyre në vazhdim gjatë një cikli certifikimi për të garantuar përputhjen me kërkesat bashkëkohore të praktikës profesionale. Ky testim do të cilësohet i kryer me sukses nëse profesionisti ka marrë të paktën 50% të pikëve maksimale. Shpallja e rezultateve do të bëhet sipas numrit të lejes së ushtrimit të profesionit dhe jo të emrit të profesionistit. Ndërkaq, profesionisti pjesëmarrës në provim ka të drejtë të përsërisë provimin e certifikimit në një kohë të dytë, jo më shumë se 5 herë.

**REZULTATET**

Ky testim do të cilësohet i kryer me sukses nëse profesionisti ka marrë të paktën 50% të pikëve maksimale. Ndërkaq, profesionisti pjesëmarrës në provim ka të drejtë të përsërisë provimin e certifikimit në një kohë të dytë, jo më shumë se 5 herë.


Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim

**DATAT E PROVIMEVE:**

- **E enjte, 7 dhjetor 2017:** Anestezi Reanimacion, Endokrinologji, Hematologji, Biokimi, Sëmundje infektive, Urologji, Obstetrike Gjinekologji.
- **E premte, 8 dhjetor 2017:** Mjekësi familje, Kirurgji, Onkologji, Ortopedi, ORL, Nefrologji, Neurologji.
- **E marte, 12 dhjetor 2017:** Neurokirurgji, Okulistike, Gastrihepatologji, Alergologji, Pediatri, Imazheri, Psikiatri.
- **E mërkure, 13 dhjetor 2017:** Reumatologji, Kardiologji, Pneumologji, Mikrobiologji, Anatomi patologjike dhe Mjekësi ligjore, Shëndet publik, Urgjenca mjekësore.
- **E enjte, 14 dhjetor 2017:** Imunologji, Dermatologji, Toksikologji, Hipertoni dhe mjekësi interne.

bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT
Implemented by giz

**OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION**

1. **GENERAL CONDITIONS**

1.1 **Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1

1.2 **Profile:** The Conservation of Agrobiodiversity in Rural Albania – CABRA Project is implemented by the Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (BMZ). The project aims to improve the conservation and sustainable use of natural and agricultural biodiversity in selected mountain areas of Albania. Das Vorhaben setzt auf nationaler Ebene (beteiligte Ministerien) und auf lokaler Ebene (in 3 Partnergemeinden) an.The project intervenes at national level (ministries involved) and at local level (3 partner municipalities Malësi e Madhe Tropojë and Shkodër).Im Handlungsfeld (1) werden Beiträge zur Neufassung der Nationalen Abfallwirtschaftsstrategie (Zwischenzeitraum 2015-2020) und der Sektorregulierung sowie zur Verbesserung der Kapazitäten und Koordinierung der beteiligten Akteure geleistet. At the local level the project contributes also to sustainable mountain development following the Sustainable Marketing and Destination Development concept for the Albanian Alps. At the local level the project supports three partner municipalities to promote the Albanian Alps as a tourism destination as well as the newly established Regional Nature Parks (RNPs) Shkrel and Nikaj - Mërtur.

1.3 **Subject:** The objective of the present call is to develop three websites for the protected areas: a) Albanian Alps b) Nikaj Mertur and c) Shkrel; respectively with domains albanianalps.al, shkrelpark.al and nikaj-merturpark.al., and train the staff of the municipality on website maintenance. In addition is required to develop the tourism logos of the Regional Nature Parks Shkrel and Nikaj –Mërtur and their brand book for logo application. We are seeking national web-design companies to (1) develop the three websites, (2) train the municipality staff on website maintenance, (3) develop manual on web-maintenance for the municipal staff, (4) design the logos of two RNPs Shkrel and Nikaj Mertur (5) prepare the brand book on logo application for RNPs. The companies' should have strong track record in website development and have previous experience on developing websites for tourism promotion. The development of the websites will be done during the period of January until end of April 2018. The process requires frequent consultations with the tourism representatives of the three municipalities for the preliminary results. All the final products resulting from this assignment will have final consent by the tourism representatives assigned by the Municipalities of Shkodër, Malësi e Madhe and Tropojë.

The team of the company (one team leader, one web developer and one designer) is expected to coordinate and harmonize their work with the GIZ / CABRA project counterparts. The company's CEO/team leader is requested to make the coordination with CABRA management and its partners. The outcome and the process will be presented to key actors.

1.4 **Eligibility:** Participation is open to all companies who are nationals of and effectively established in Albania.

All legal entities interested in the application process should ask for application forms to the address: giz-albanien@giz.de

2. The due date for submitting the application is **5th[nd] December 2017**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Website and logo development for the Albanian Alps" to:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1, Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated and only prequalified candidates will be invited to answer the bid.

"Me ta nuk kontaktonim prej vitesh. Ne i kemi dhënë pistat ku dyshojmë"

# "Atentati që iu bë djalit s'ka lidhje me dy vrasjet në Vlorë e në Durrës"

## Prindërit e Inez Hajrullës: Jemi kushërinj të largët

**VLORË**

"Atentati që iu bë djalit nuk ka asnjë lidhje me vrasjen e dy të afërmve tanë. Me ata nuk kontaktonim prej vitesh, jemi kushërinj të largët". Kështu kanë deklaruar në polici familjarët e 25-vjeçarit Inez Hajrulla, i cili u gjymtua rëndë pas shpërthimit të një sasie prej 300 gr C4 në automjetin e tij tip "Jeep". Ngjarje kjo e ndodhur paraditen e së hënës, në vendin e quajtur "Bishti i Kalldrëmit" në qytetin e Vlorës. Pak ditë pas ngjarjes së rëndë që tronditi banorët e qytetit bregdetar, hetuesit e çështjes kanë marrë në pyetje prindërit e të riut, që si pasojë e shpërthimit të tritolit humbi njërën këmbë. Mësohet se familjarët e të mbijetuarit të atentatit kanë dëshmuar në ambientet e policisë së Tiranës, për shkak se ndodhen afër djalit të tyre, i cili është duke marrë ndihmë mjekësore në reanimacionin e Spitalit të Traumës. Prindërit e të plagosurit, Inez Hajrulla dyshojnë që autori është në Vlorë, por nuk japin detaje të tjera. Ndërsa, mohojnë kategorikisht që atentati ndaj djalit ka lidhje me ekzekutimin e Renato Imerit më 31 korrik të këtij viti pranë një lokali në Lungomare dhe me vrasjen Endri Çaushit më 21 dhjetor 2015-ës në një atentat në Durrës.


25-vjeçari i plagosur, Inez Hajrulla


Makina ku shpërtheu tritoli

**DËSHMIA E FAMILJARËVE**

Dy ditë më parë, burime të rezervuara nga blutë e qytetit bregdetar konfirmuan për "GSH" se 25-vjeçari Inez Hajrulla (person me precedent penalë) kishte lidhje gjaku me Renato Imerin, që u vra pak muaj më parë në Vlorë dhe me Endri Çaushin, që u ekzekutua dy vite më parë në Durrës. Po të njëjtat burime thanë se të dyja këto ngjarje i janë bashkangjitur dosjes së hetimeve, për të mësuar nëse atentati i ndodhur paraditen e së hënës ka lidhje apo jo me këto dy vrasje. Ndërkaq, familjarët e të plagosurit nuk pranojnë që atentati që iu bë djalit të tyre të ketë lidhje me këto dy ngjarjeje. Ata u shprehën para hetuesve të çështjes se Inezi lëvizte lirisht në çdo qytet të Shqipërisë dhe se nuk ka pasur konflikte në Durrës. "Ne i kemi dhënë pistat ku dyshojmë", pohuan ata. Mësohet se 25-vjeçari që humbi njërën këmbë ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore. Emri i tij i vërtetë është Imer dhe është djali i biznesmenit të njohur në Vlorë, Robert Hajrullës. I riu njihet ndryshe edhe si Ini i Çones dhe është kushëriri i Renato Imerit, 36-vjeçarit i njohur ndryshe si "Reni", që u vra disa muaj më parë me armë zjarri në zonën e Lungomares në Vlorë dhe gjithashtu, kushëri me Endri Çaushaj, i ekzekutuar në Durrës.

**ARRESTIMI**

Dy ditë më parë, policia e Vlorës arrestoi Inez Hajrullën, pasi gjatë kontrollit të ushtruar në makinën e tij tip "Jeep" u gjet një çantë supi, brenda së cilës kishte një pistoletë tip "Glock", me fishek në fole dhe 17 fishekë në krehër. Të njëjtat burime pohuan se edhe një vit më parë, i riu Hajrulla është arrestuar po për të njëjtën vepër penale, atë të: "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe e municionit". Po ashtu, policia e qytetit bregdetar bëri me dije se 25-vjeçari që u plagos në atentat është shtetas me precedentë të theksuar kriminalë, i dënuar më parë për disa vepra të ndryshme penale në fushën e krimeve kundër personit, vjedhje me dhunë dhe trafikim të mjeteve motorike.



## Arrestohen 2 vëllezërit hajdutë, u gjenden armë e municione dhe fenelina policie

**DURRËS** - Policia e Durrësit ka vënë në pranga dy persona, të cilët akuzohen të jenë autorë të disa vjedhjeve. Bëhet fjalë për vëllezërit Hamid Bala 28 vjeç, dhe E.B. 16 vjeç nga fshati Karpen i Maminasit. Gjatë kontrollit policor, atyre u janë gjetur dhe sekuestruar armë, municione luftarake, një automjet, fenelina policie si dhe karta telefoni të kompanive të ndryshme. Sipas bluve të qytetit bregdetar, vëllezërit Bala u prangosën në flagrancë gjatë operacionit të koduar "Rakordimi". Hetuesit e çështjes pohuan se Hamid Bala ka qenë i dënuar më parë për veprat penale: "Plagosja", "Armëmbajtje pa leje" dhe "Vjedhje të energjisë elektrike". Gjithashtu, edhe vëllai i tij 16-vjeçar ka qenë i dënuar më parë. Mësohet se grupi hetimor ka zbardhur dhe dokumentuar me prova shkencore dhe procedurale se shtetasit e mësipërm janë autorë të dyshuar të vjedhjes së magazinës së shtetasit E.Z.; vjedhjes së servisit së shtetasit M.N., ku kanë vjedhur vlera monetare, sende të ndryshme materiale, telefona celularë si dhe vjedhjes së një çante, marsup shtetasit S.B.. Në momentin e kapjes së shtetasve të mësipërm si edhe gjatë kontrollit të kryer në banesat e tyre janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provave materiale: 1 armë zjarri pistoletë tip "Ecol" së bashku me një krehër me 9 fishekë; 1 armë gjahu tipi "Shutgan", ku brenda folesë së saj gjendeshin 4 fishekë; 1 armë gjahu me grykë, e cila kishte të stampuar PBERETTA; 1 pushkë sportive, 1 dorezë arme gjahu "Shutgan", 169 fishekë kal.7.62 mm mod 56, 1 automjet tip "Benz CLK 230", kompresor së bashku me dokumentacionin dhe të instaluara një palë fenelina policie, 6 palë targa. Sendet e vjedhura në pronën e shtetasve E.Z. dhe M.N.; 1 palë dylbi, 3 telefona smartphone, 11 karta telefoni të kompanive të ndryshme celulare dhe 1 kamera e markës 'JVC COMPACT VHC'. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme për veprat penale "Vjedhja" në bashkëpunim, "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve luftarake", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive" dhe "Mbajtje pa të drejtë e uniformës dhe simboleve".

## Reshjet, prezente nga 30 nëntori deri më 4 dhjetor

# Emergjencat Civile: Shirat mund të shkaktojnë përmbytje, më të rrezikuara Fieri dhe Vlora

**TIRANË** - Emergjencat Civile paralajmërojnë se mund të ketë përmbytje në disa zona të vendit, për shkak të reshjeve të shiut, që priten të nisin mëngjesin e ditës së sotme. Përmes një njoftimi për mediat, EC bëjnë me dije se janë marrë masa emergjente për situata të pritshme të parashikuara nga IGJEUM dhe institucionet ndërkombëtare të monitorimit të përmbytjeve për Evropën, të cilat parashikojnë reshje shiu me intensitet të lartë.

Sipas Institutit të Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), por edhe nga shërbimet meteorologjike që bashkëpunojnë me Emergjencat Civile, informohemi paraprakisht se moti në të gjithë territorin e vendit gjatë datës 30 nëntor deri më 4 dhjetor 2017, do jetë drejt përkeqësimit dhe priten reshje shiu me intensitet mesatar deri dhe me intensitet të lartë, të cilat mund të krijojnë mundësinë e përmbytjeve. Përgjatë këtyre ditëve priten reshje shumë intensive, pothuajse në të gjithë territorin, por edhe jashtë kufijve shtetërore në basenin e lumit Vjosa. Reshjet maksimale i kalojnë vlerat e 100 mm në 24 orë. Nga llogaritjet paraprake, këto reshje priten të sjellin përmbytje në lumenjtë e mëdhenj, përveç vërshimeve të lumenjve të vegjël dhe përmbytjeve urbane në varësi të gjendjes së kanalizimeve në qytetet kryesore (Tiranë, Lezhë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Fier dhe Gjirokastër). Qarqet më të rrezikuara janë Fieri dhe Vlora. Ka mundësi të lartë për përmbytje në basenet e lumenjve Vjosa dhe Seman. Gjithashtu, edhe lumi Shkumbin mund të shfaqë përmbytje përgjatë fundit të ditës së premte. Efektet e rëndësishme të përmbytjeve në pjesët fushore të qarqeve Vlorë dhe Fier parashikohet se mund të ndodhin në pjesën e parë të ditës së shtunë, 2 dhjetor 2017. Në pjesët e sipërme të këtyre baseneve në qarqet (Gjirokastër, Berat, Elbasan) përmbytjet mund të ndodhin përgjatë ditës së premte, 1 dhjetor 2017.

Për sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile udhëzon në mënyrë të veçantë të gjithë prefektët e qarqeve, drejtuesit e bashkive, drejtuesit e institucioneve qendrore rajonale dhe vendore për marrjen e masave urgjente për sigurimin e kushteve për jetën normale të komunitetit.

**MASAT PËR PËRMBYTJET**

- Të mbledhin urgjentisht Komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile (Shtabin e Emergjencave Civile) në rang qarku dhe bashkie, duke dhënë detyra për çdo institucion që ka përgjegjësi për emergjencat civile.
- Të kërkojnë menjëherë raport nga drejtuesit e Drejtorive Rajonale të ARRSH, Shëndetësisë, OSHEE-së dhe të gjitha institucioneve të tjera rajonale me varësi qendrore, në lidhje me masat e marra për përballimin e situatës nga reshjet dhe përmbytjet.
- Të bashkëpunojnë me subjektet kontraktore dhe Drejtoritë e Rajoneve të ARRSH për mbajtjen e akseve rrugore të hapura për qarkullimin e mjeteve.
- Të kontaktojnë me drejtuesit e Policisë së Shtetit për monitorimin e akseve rrugore dhe për mbajtjen hapur të tyre për qarkullimin normal të mjeteve.
- Të sigurojnë në bashkëpunim me OSHEE mirëmbajtjen e linjave të furnizimit me energji elektrike të komunitetit dhe në mënyrë të veçantë të furnizimit të hidrovorëve, ujësjellësve të qyteteve dhe fshatrave. Të angazhojnë struktura për mbikëqyrjen e nivelit të lumenjve dhe forcojnë argjinaturat në pika të dobëta.
- Të sigurojnë ujësjellësit dhe tubacionet e furnizimit të ujit të pijshëm, si dhe aksesorët e tyre, për problemet që mund të shkaktohen nga përmbytjet.
- T'u krijohen mundësitë për veprim të gjitha strukturave operacionale të EC si: Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, ARRSH, për të përmirësuar situatën.
- T'u kërkojnë kompanive private, pavarësisht kontratave të punës, që të angazhohen në ndihmë të shtabeve të emergjencave civile në bashki e prefektura.
- Të sigurojnë paraprakisht mjete transporti dhe pastrimi nga subjektet private apo individë për t'i pasur në gatishmëri për përballimin e çdo situate emergjente që mund të krijohet.
- T'u kërkojnë Drejtorive të Bordeve të Kullimit dhe strukturave të hidrovorëve, si dhe OSHEE, të fillojnë nga puna menjëherë për të minimizuar pasojat që mund të shkaktohen nga reshjet e dendura.
- Të marrin masa për njoftimin e komunitetit të tyre që t'i bindet lajmërimit të strukturave të pushtetit vendor dhe qendror për të shmangur qarkullimet e panevojshme, për minimizimin e lëvizjeve të shumta të popullatës dhe sidomos e fëmijëve të mitur të pa shoqëruar nga të rriturit, si dhe të japin ndihmesën e tyre ndaj këtyre strukturave.

### Prokuroria, dyshime se udhëtoi me makinën e Habilajve

# Çështja "Habilaj", Elona Gjebrea kërkesë prokurorisë për të dëshmuar

E vënë në qendër të akuzave se ka udhëtuar me makinën e Habilajve 3 vjet më parë, ish-zëvendësministrja e Brendshme, Elona Gjebrea kërkon të sqarojë pozicionin e saj përballë drejtësisë. Gjebrea insiston të paraqitet vullnetarisht në organin e akuzës dhe të japë shpjegime në funksion të hetimit të çelur ndaj ish-ministrit të Brendshëm. Burime pranë organit të akuzës thanë se deputetja Gjebrea u ka dërguar një memo, përmes së cilës kërkon t'i caktohet një takim, me qëllim që të japë shpjegime lidhur me këtë histori. Dyshimet rreth saj lindën pas gjurmimit të sistemit TIMS, ku rezulton se më datë 8 gusht 2018, Saimir Tahiri dhe Elona Gjebrea kanë udhëtuar në drejtim të Greqisë nëpërmjet portit të Sarandës. Tetë ditë më vonë, më 16 gusht ministri dhe zëvendësja e saj kanë hyrë në territorin shqiptar përmes pikës së kalimit kufitar të Qafë-Botës. Burimet thonë se Saimir Tahiri drejtonte makinën tip "Audi" me targa AA 003 GB, dikur në pronësi të tij, por dy muaj pasi mori detyrën e ministrit të Brendshëm ua kishte shitur vëllezërve Habilaj.

Drejt Greqisë me këtë makinë rezulton të ketë udhëtuar më 14 gusht 2014 Artan Habilaj, duke ia dorëzuar atje Tahirit, i cili e ka drejtuar në kthim. Sakaq, deputetja e PS, Elona Gjebrea pret një konfirmim nga organi i akuzës lidhur me datën dhe orën se kur mund të paraqitet të japë shpjegime.

**KËRKESA**
Elona Gjebrea insiston të paraqitet vullnetarisht në organin e akuzës dhe të japë shpjegime në funksion të hetimit të çelur ndaj ish-ministrit të Brendshëm. Burime pranë organit të akuzës thanë se deputetja Gjebrea iu ka dërguar një memo, përmes së cilës kërkon t'i caktohet një takim.


Ish-zëvendësministrja e Brendshme, Elona Gjebrea

### Policia: Në kërkim Daniel Manushi dhe bashkëpunëtori

# Plagoset me armë zjarri, polici: I njoh të dy autorët

## "Më thanë 'pse na shikon' e më qëlluan"

Ina Allkanjari

**TIRANË**

Njëri prej tyre më tha 'pse na shikon'. Gjithçka ndodhi në pak minuta për arsye banale", kështu ka dëshmuar dje para forcave policore, Ermal Bregu, efektivi i plagosur mbrëmjen e së martës, në rrugën "Kongresi i Lushnjës" në Tiranë. Gjatë dëshmisë së dhënë, 33-vjeçari ka identifikuar dy autorët, të cilët ai tha se i njihte dhe ka mohuar që të ketë pasur konflikte të mëparshme me ta. "Dy personat i njoh, sepse jemi në një lagje. Nuk kam pasur konflikte të mëparshme me ta. Gjithçka ndodhi në pak minuta për arsye banale. U gjendëm përballë dhe më thanë 'pse na shikon'. Më fyen dhe pastaj u grindëm me fjalë. Pastaj njëri prej tyre nxori pistoletën dhe më qëlloi", ka dëshmuar Ermal Bregu para grupit hetimor. Pas dëshmisë së 33-vjeçarit, policia e Tiranës ka identifikuar 2 autorët dhe i ka shpallur në kërkim. Mësohet se personi i cili plagosi punonjësin e komisariatit nr.1 në kryeqytet, Ermal Bregun, është shtetasi Daniel Manushi. 23-vjeçari me nënshtetësi gjermane është shpallur në kërkim nga policia, si autor i dyshuar i vrasjes së mbetur në tentativë të policit, si dhe me akuzën e armëmbajtjes pa leje. Gjithashtu, është shpallur në kërkim edhe një person tjetër, i cili dyshohet të jetë bashkëpunëtor i 23-vjeçarit Manushi. Autorët rezultojnë që nuk kanë precedentë të mëparshëm penalë. Arrestimi i tyre pritet të hedhë më shumë dritë mbi shkaqet e konfliktit, pasi ata të japin versionin e tyre. Sipas dëshmisë së policit 33-vjeçar, ditën e ngjarjes, autori Daniel Manushi dhe miku i tij dyshohet të kenë qenë të ulur në të njëjtin lokal me Ermal Bregun dhe pas konfliktit verbal, mes tyre ka nisur një debat i fortë, i cili ka vijuar në rrugë (në zonën e ish-Parkut të autobusëve). Aty 23-vjeçari ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar dy herë efektivin e policisë, i cili mori plagë në parakrah dhe në bark. 33-vjeçari u dërgua menjëherë në spitalin e traumës ku dhe është jashtë rrezikut për jetën. Sakaq, policia e Tiranës nga informacionet e marra në rrugë operative kanë dyshime se efektivi i policisë dhe dy autorët janë konfliktuar një muaj më parë, por nuk dihen ende shkaqet e grindjes. Mësohet se efektivi do të merret sërish në pyetje në një moment të dytë. Sakaq, dy autorët janë shpallur në kërkim dhe policia e Tiranës dhe po vazhdon hetimet për të zbardhur ngjarjen.


Autori, Daniel Manushi


Efektivi i plagosur, Ermal Bregu

**AUTORI**
23-vjeçari Daniel Manushi me nënshtetësi gjermane është shpallur në kërkim nga policia, si autor i dyshuar i vrasjes së mbetur në tentativë të policit, si dhe me akuzën e armëmbajtjes pa leje. Gjithashtu, është shpallur në kërkim edhe një person tjetër, i cili dyshohet të jetë bashkëpunëtor i tij.

**DËSHMIA**
"Dy personat i njoh, sepse jemi në një lagje. Nuk kam pasur konflikte të mëparshme me ta. Gjithçka ndodhi në pak minuta për arsye banale. U gjendëm përballë dhe më thanë 'pse na shikon'. Më fyen dhe u grindëm me fjalë. Pastaj njëri prej tyre nxori pistoletën dhe më qëlloi", ka dëshmuar Ermal Bregu para grupit hetimor.

**NGJARJA**

Ne punojmë me tituj e grada, të cilët mbi bazën e ligjit në fuqi, këtu a në universitete, kudo qoftë, kanë standardizimin e vet dhe mbi atë bazë paguhen. Por që të diferencohet pozitivisht, të stimulohen njerëzit që të jenë aktivë, duhet të funksionojë edhe ligji për pagesa honoraresh. Një problem ka qenë edhe shkolla doktorale, por tani është zgjidhur nga ligji. Për një doktoraturë paguhej 2 milionë lekë të vjetër dhe realisht kushtonte më shumë se 3 milionë, ne krijuam deficit. Të gjitha problemet ia kemi paraqitur parlamentit edhe në një takim të para disa javëve.

**- Me ambientet, jeni rregulluar ende?**
Me ambientet kemi ende kubatura që janë vetëm 40% e mesatares ballkanike, për këtë arsye ne kemi vënë 3-4 profesorë në një dhomë-zyrë, që është e papëlqyeshme. Ndërkaq, duke qenë të ndarë në dy godina kemi të ndarë edhe arkivin dhe jemi në një distancë gati 3 km nga njëra-tjetra. Tani që ishpalestra që u sistemua për të qenë pjesë e jona, uroj të na jepet, pasi aty për disa kohë që vendosur Ministria e Integrimit. Kjo do i jepte një zgjidhje afatmesme të pëlqyeshme punës sonë, sepse do të gruponim aty studiuesit, do kishim më tepër metra katrorë në dispozicion e do të gruponim bibliotekat dhe arkivat.

ka Akademia e Shkencave, pas dy muajsh kërcënime për shkrirje e prerje fondesh.
U tha se "Ne mund të bëjmë një kuvend të shkencës dhe dijes që t'u japë mundësi atyre që kanë dëshirë, pasion dhe ndjenë detyrimin për të dhënë për shkencën e dijen në këtë vend që të jenë të përfaqësuar dhe të jenë në shoqërinë e tyre dhe jo në një shoqëri që nuk merret vesh ku mbaron profesori i nderuar dhe ku fillon një mashtrues, një marifteçi, një zullumqar që bën lëmsh gjithë sistemin".
Kryeministri tha se "Shyqyr që Eqrem Çabej e ca të tjerë janë në botën tjetër, përballë kësaj marrëzie që kemi para nesh, me emrin Akademia e Shkencave. Nëse do të shohim përgjegjësitë, sigurisht janë të gjithanshme, secili ka të vetat". Ai kujtoi se herën e parë kur u takuan ishte gjallë akoma Alfred Uçi. Sot nuk është më. "Unë uroj që të gjithë të jemi gjallë kur të takohemi përsëri, po këtu njerëzit po ndahen nga kjo botë dhe Akademia po mbetet si vendi ku po organizohen funeralet. Është bërë si shtëpi varrimi. Hap derën për të nxjerrë arkivolet jashtë. Nuk mund të vazhdojë më kështu dhe ju të gjithë jeni të vetëdijshëm për këtë".
Teksa kritikoi botimet e Akademisë që sipas tij janë sa dramatike dhe komike, pa asnjë recensë e pa asnjë oponencë, tha se duam të fuqizojmë qoftë "Qendrën e Studimeve Albanologjike se është një pikë themelore dhe referencë themelore e asaj, që mund të quajmë sot kërkimi shkencor në Shqipëri, për çka u takon domosdoshmërive që kanë të bëjnë me trashëgiminë, me identitetin dhe me gjuhën tonë".

# KUMBARO: DEBATI PËR 29 NËNTORIN? UNË DO ISHA ME PARTIZANËT

### Ministrja e Kulturës për debatin: Edhe historianët të ndarë në llogore

Ministrja e Kulturës Mirela Kumbaro është ndalur dje në debatin për festën e Çlirimit. Duke sqaruar pozicionin e saj si pasardhëse e një familjeje që ka pasur partizanë, është shprehur se edhe tani do zgjidhte partizanët. Kumbaro thekson se "Nuk do të reshtja së thëni se regjimi i Hoxhës që u vendos më pas ishte një fatkeqësi kombëtare dhe aspak një përkthim i idealit për të cilën luftuan partizanët", duke vërejtur se tezja e saj doli partizane edhe pse më pas në familjen e saj pati të burgosur si armiq të popullit. SHËNIMI: "29 Nëntor 2017. Debati, me dashje i pashteruar, për datën 29 Nëntor nuk e ndryshon dot historinë. Pasi i lodhi mediatikisht historianët (fatkeqësisht edhe këta shpesh të ndarë në llogore politike), ai veçse vijon të mbushë tashmë portalet duke mos ndarë - sërish me dashje - 29 Nëntorin si simbol të përfundimit të Luftës Antifashiste, të rreshtimit të Shqipërisë krahas Forcave Aleate dhe të Çlirimit të vendit nga nazistët, nga fillimi i një periudhe të errët e të rëndë për historinë e Shqipërisë e të shqiptarëve, atë të diktaturës më të egër e më të gjatë që ka njohur Europa. Me profesion nuk jam historiane, prandaj nuk marr përsipër të bëj asnjë gjykim historiografik. Por jam edhe e angazhuar politikisht, e prandaj akoma më pak do e bëja një gjë të tillë, sepse historinë nuk e shkruajnë politikanët, por historianët. Por, jam shqiptare dhe bash si e tillë, sikur 100 herë të më pyesin se nëse do të kisha jetuar Luftën e Dytë Botërore nga cila anë do të rreshtohesha, 100 herë do të përgjigjem "me partizanët". Siç bëri tezja ime që doli partizane në moshën 17 vjeç, siç bëri ati i saj e gjyshi im që i mbështeti me sa mundi financiarisht e materialisht, siç bëri familja e tim ati që numëron partizanë e dëshmorë. Por, po ashtu 100 herë e më shumë, nuk do të reshtja së thëni se regjimi i Hoxhës që u vendos më pas ishte një fatkeqësi kombëtare dhe aspak një përkthim i idealit për të cilën luftuan partizanët; përndryshe tezja ime s'mund të kishte dalë partizane që vetëm pak vite më vonë të dy prindërit (gjyshërit e mi) t'ia burgosnin me cilësimin "armik të popullit"; përndryshe familja e tim ati s'do të ishte radhitur me shumicë me partizanët që tim atë e jo vetëm, ta ndëshkonin në vitet 70 për "ide liberale" dhe "shkelje të vijës së partisë", ndonëse punoi ndershmërisht e besoi verbërisht te një ideal ireal. Asgjë e jashtëzakonshme në këto episode, përveçse një "déjà vu" e të gjitha familjeve shqiptare. Siç është pjesë e jetës së të gjithë brezit tim që jetoi fundin e viteve '80, padurimi, dëshira, përpjekja dhe veprimi, gjithkush sa mundi, - por padyshim i të gjithëve bashkë, - për të rrezuar diktaturën. Kaq. Historinë do ta shkruajnë historianët e brezit tjetër, që do të jenë të shkarkuar nga vrandërgjegjet e profesionit të ushtruar nën diktaturë. Deri atëherë shoqëria do të evoluojë më mirë. Sot dua të them: Gëzuar 29 Nëntorin që na kujton aleancën e Shqipërisë me forcat antifashiste dhe kur përkujtojmë me përulje ata të rinj që dhanë vitet e rinisë dhe jetën për një dashuri të madhe fare, te e cila besuan fort, dashuria për Atdheun!"




> "Historinë do ta shkruajnë historianët e brezit tjetër, që do të jenë të shkarkuar nga vrandërgjegjet e profesionit të ushtruar nën diktaturë. Deri atëherë shoqëria do të evoluojë më mirë.

Opinioni i Ditës

# Kosova dhe Shqipëria, sa shumë fjalë... për ndarjen

Nga Ben Andoni

*(Vijon nga faqja e parë)*

... të shfryjnë pasiguritë e tyre dhe të ç'tensionojnë situatat e ndera që i rrethojnë. Ato së bashku, ku kjo e fundit mund të quhet disi maratonike, sepse nisi në Korçë dhe përfundoi në Vlorë, duhet të vlerësohen për ritmin institucional, por aspak për atë që kanë arritur deri më tani në praktikë. Nga burimet zyrtare pas këtyre mbledhjeve flitet shpesh për produkt të mirë dhe realisht gjëra të prekshme. Vetëm se publiku në Kosovë e Shqipëri i gjykon ato si thjesht me sfond patriotik e patetike, por me asnjë impakt real për vendet tona. Vërtetë janë institucionalizuar marrëveshje për kulturën, gjuhën, ekonominë, dhe së fundmi marrëveshja lidhur me pensionet, që përbëjnë interes të madh për qytetarët. Vetëm, kur të preken realisht dhe të japin ndikim atëherë do të konsiderohet produkti i këtyre mbledhjeve të maturuara shumë mirë nga ana protokollare. Të dy popujt shqiptarë, këndej dhe andej kufirit janë tashmë të sfilitur nga qeverisjet e dobëta, që kanë sjellë skamje ekonomike, papunësi galopante, arsimim katastrofik, nivelin e ulët të shëndetësisë, pa folur për kuotat e pensioneve, pabarazinë e tmerrshme sociale e mbi të gjitha me krimin që është rritur frikshëm. Rezultati: një masë e madhe e njerëzve tanë ikin e ikin dhe e kanë bërë Kosovën e Shqipërinë të renditen si ndër vendet e para në Evropë sa i përket të larguarve.

Edhe që Shqipëria dhe Kosova përsëritet se kanë marrëdhënie vëllazërore, kjo është bërë e lodhshme për veshët e njerëzve. Në fakt, nuk kemi pse të jemi vëllezër, jemi një, në rast se konsiderohemi si pjesë e një trungu. E frikshme është mënyra sesi e përdorin politikanët këtë ligjëratë patetike për të fituar pikë. Pak muaj më parë, në një periudhë të turbulluar në vend, kryeministri i vendit Edi Rama doli me versionin e bashkimit me Kosovën, nëse do dështonte projekti i integrimit evropian. Të mendosh që deri më atëherë i njëjti kryeministër tregonte një fytyrë tjetër me Bashkimin Evropian në kuadër të procesit të Berlinit. Njësoj po ndodh me kryeministrin e ri të Kosovës, Ramush Haradinaj, para të cilit shtrihen probleme jetike dhe gati të papërballueshme për filozofinë e tij të drejtimit, me të cilin u përball në fushatë me qytetarët e vet. Erdhi me një qeveri maksimaliste në përbërje, ndryshe nga akuzat që bëri deri më atëherë për paraardhësit, ndërsa për Demarkacionin sot e kësaj dite nuk ka dhënë një drejtim sesi do të procedojë, përveç propagandës dhe mëtimit të stërpërsëritur se kanë gjetur elementë që kufiri është në Çakorr.

Duke e ditur mentalitetin që sundon në dy vendet tona, atëherë e kupton se, nëse bashkimi dhe afrimi në një njësi me treg të përbashkët funksional ishte një realitet gati i prekshëm para luftës dhe pothuaj edhe pak pas luftës, tashmë ky opsion është tejet larg. Janë pengesa të stërmëdha që i bëjnë këto mundësi gati nul. Dhe, janë pengesa ende më të mëdha që dy shtetet të funksionojnë si duhet me një filozofi të përbashkët dhe të përafrojnë mentalitetet. Akoma qytetarët kosovarë janë të mësuar dhe të lidhur me mënyrën e vjetër sllave të jetuarit dhe të organizimit, ashtu si shqiptarët e Shqipërisë e kanë tejet larg mënyrën e jetesës kosovare me aksesorët e saj. Që do të thotë edhe shkëmbimet nuk mund të jenë të mëdha. Në praktikë ata nuk arrijnë njohjen e ndërsjellë të certifikatave shkollore, kumtonte në formë ironike "Der Standard" para do kohësh. Megjithatë, kryeministri shqiptar e ka zgjidhur mëdyshjen me shpalljen indirekt të "Shqipërisë së madhe" që e ka tundur frikën e nacionalistëve në Maqedoni dhe Serbi, që nuk lënë rast pa e kujtuar dhe u ankuar. Në një farë mënyre, Edi Rama ka bërë atë që presidenti Vuçiç e bën rregullisht ndaj Bashkimit Evropian duke i kujtuar Rusinë.

Duhet sqaruar se marrëdhënia Shqipëri-Kosovë është institucionale qysh në mbledhjen e parë të përbashkët në Prizren, kur është nënshkruar partneriteti strategjik mes dy vendeve. Nëse do të futesh në elementë teknikë ose specialistë të fushave të ndryshme mund të zbulojnë shumë anomali, që janë vërejtur në harkun kohor mes takimeve, por përshtypje bën se është shumë larg ajo që thuhet me atë që realizohet. A mund të thotë një burim zyrtar pse Autostrada e Kombit është sot e kësaj dite e pambaruar? Ajo arrin deri në Milot. E të shkosh në Durrës të duhen dhe po aq sa nga Prishtina. A mund të thotë dikush vallë pse porti i Shëngjinit, që do të ishte porti i Kosovës nuk është i tillë, ende sot e kësaj dite? A mund të thotë dikush pse përsëriten anomalitë në tregtimet e mallrave mes dy vendeve tona? Apo pse nuk punon si duhet portali albanologjik, që duhej mbajtur më kontributet e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani"? Pse u shpall xhanëm kur nuk e mbanin dot?!




Ashtu, si është përsëritur, marrëveshjet do funksionojnë kur të krijohen dhe të punojnë si duhet mekanizmat ekonomikë. Jashtë retorikave, por në vazhdë të atyre dokumenteve që janë firmosur ka ardhur koha që institucionet të krijojnë mekanizmat e duhura t'u japin jetë marrëveshjeve bashkë me instrumentet e duhura të monitorimit. Me çfarë kuptohet nuk ka buxhete të përcaktuara, sa i përket bashkëpunimeve në kulturë, art, media dhe sport dhe kjo vazhdon edhe me sektorët e tjera, ndaj kjo i bën marrëveshjet që të jenë shumë burokratike dhe korteziale. Ndaj, në një pikë, të gjitha vërejtjet bashkohen: koreografitë patriotike dhe nënshkrimi i dokumenteve të shumta është tejet larg nivelit të vërtetë të marrëdhënieve të Shqipërisë me Kosovën. Vërtetë ka shumë syresh, gati të pamundura të numërohen, porse mbetet një mal me detyra të lëna përgjysmë mes dikasteresh të tëra.

Dhe, në këtë rast, kur vjen puna te bilanci atëherë ia vlen që këto takime të dëgjohen, por të konsiderohen vetëm nëse do të trandin diçka. Deri më tani, tamtamet patriotike për rezultatet pozitive nuk i pengojnë shqiptarët e kosovarët të ikin nga sytë e këmbët e larg vendeve të tyre.

***(Gazeta shqiptare)***

# Hop cilësor me Luksemburgun

Nga Jorgji KOTE

Dëshmia më e freskët e këtij hopi ishte pritja dhe mbrëmja festive që ambasada jonë me seli në Bruksel organizoi disa ditë më parë në Luksemburg. Ishte aktiviteti i parë pas dy dekadash i këtij formati me rastin e Ditës së Flamurit. Merita u takon dhe dashamirësve të vendit tonë, që me mbështetjen e tyre bënë të mundur zhvillimin e kësaj veprimtarie të bukur në hotelin më prestigjioz, me një prani elitare e të larmishme, të shoqëruar nga tingujt e muzikës tradicionale dhe pamjet mbi transformimet e shumta në vendin tonë. Kur flitet për një hop e pse jo kthesë cilësore në marrëdhëniet me një vend me vetëm 550.000 banorë dhe sipërfaqe 2856 km katrorë, dikush mund të ngrejë supet. Mirëpo fakt është se vetëm këto dy tregues gjeografikë të Luksemburgut janë të "vegjël". Gjithë treguesit e tjerë jetikë, nga emri, historia, traditat dhe mundësitë e bashkëpunimit, janë "të mëdha". Në aspektin ekonomik, Luksemburgu ka GDP-në më të lartë në botë për frymë, ka mbi 150 banka private, Fondin më të madh të Investimeve në Evropë dhe të tjerë tregues të spikatur.

Gjithsesi, mjaftojnë vetëm disa fakte që përmenden më poshtë për të kuptuar se aseti më madhor i lakmueshëm, një model nga i cili kushdo mund të mësojë shumë është fryma dhe orientimi i theksuar Euro-Atlantik i Luksemburgut. Me vizionin e tyre largpamës, liderët e tij bashkë me ata të Belgjikës dhe Holandës krijuan Bashkimin e tyre Ekonomik dhe Doganor qysh në vitin 1944 në mërgim në Britani. Falë përvojës së gjatë e të pasur, "Benelux" është "inkubator, laboratori dhe kopsht eksperimental" ligjor për BE-në" në fushat më jetike të tij, si dhe model për "Beneluksin Ballkanik".

Mbi të gjitha, Luksemburgu është të bashkëthemelues i OKB-së, NATO-s dhe një nga 6 vendet e para të BE-së qysh me krijimin e saj më më 1957, etj.

Ndaj, vërtet që "boshti"/"motori" i BE-së ishte dhe mbetet Franca & Gjermania; por, prania sidomos e Luksemburgut pati domethënien e vet të veçantë simbolike dhe politike.



Mesazhi ishte se tashmë BE do të përfaqësonte pa dallim të gjitha vendet, të mëdha e të vogla, fituese dhe humbëse, sipas parimit "me BE fitojnë të gjithë"

Luksemburgu është "bujtës" i institucioneve të rëndësishme evropiane, si Gjykata Evropiane e Drejtësisë, Banka Evropiane e Investimeve ( BEI) etj. Për rrjedhojë, krahas Brukselit dhe Strasburgut, qyteti i Luksemburgut është "kryeqyteti" i tretë i Evropës.

Ky vend i ka dhënë BE-së dy Presidentë të Komisionit Evropian - Jacques Santer dhe tani Jean Claude Juncker bashkë me disa komisionerë, miq të dashamirës të vendit tonë.

Duke patur shumë pika të përbashkëta të të kaluarës me vendet e rajonit tonë, Luksemburgu i ka thënë ndër të parët "PO" aderimit të tyre në NATO dhe në BE. Këtë mbështetje pa rezerva ai e ka dhënë sidomos për vendin tonë gjatë 27 viteve të fundit, duke filluar nga ndihmat ekonomike dhe humanitare për spitale, për zona të prapambetura ekonomike, përmbytje deri te mbështetja për antarësimin në NATO, njohjen ndër të parët të Pavarësisë së Kosovës dhe mbështetjen pa rezerv për statusin kandidat në BE.

Në gjysmën e dytë të vitit 2015 Luksemburgu kryesoi me shumë sukses veprimtarinë e ➔

Opinioni i Ditës

# Shqipëria, si një kartë krediti për hipokritët

Nga Lorenc Vangjeli

(Vijon nga faqja e parë)

... të banuar me shqiptarë. Garë për valëvitje flamujsh, garë për retorikë rilindjeje, garë për fron patriotizmi që lartohet sidomos kur kundërshtari gjykohet si tradhtar, garë në klube dhe garë në politikë; në thelb një garë e pafundme që si rregull njeh për fitues hipokritët.

Ata që e kanë përdorur gjithmonë Shqipërinë si kartë krediti. Si një kartëmonedhë që i paguhej shtypësit më të parë.

Pak më shumë se një shekull shtet i mosvarur, Shqipëria sot ka një mori dilemash për të shkuarën e të tashmen e saj dhe sidomos për orientimet e saj në të nesërme, kryesisht për rolin e saj në rajon e diçka më gjerë. Çfarë na bën kaq të ndryshëm nga grekët e serbët, nga turqit e maqedonasit, nga italianët e gjermanët, nga amerikanët e australianët, nga rusët e kinezët? Dhe çfarë na bën njëlloj si gjithë ata në trajektoren e jetës duke qenë në thelb të njëjtat qenie njerëzore, që në adoleshencë kërkojmë të ndryshojmë gjithë botën, në moshë të pjekur kërkojmë të zmadhojmë shtëpinë ku banojmë dhe në moshë të thyer, ëndërrojmë vetëm për një tualet të përshtatshëm për të këndellur kolitin dhe therjen e zorrëve të lodhura? Çfarë na bën krenarë në qenësinë tonë kombëtare?

Në Shqipëri, të mëdhenj e të vegjël, të votuar dhe votues, të pasur e të varfër, të mençur e budallenj, mburren me çfarë ka bërë Perëndia për këtë vend, por padyshim kemi tmerruar dynjanë me qindin që i kemi punuar vendit. Ne vazhdojmë t'i këndojmë hijes së rëndë të kështjellave, por na vjen për mbarë t'u heqim edhe gurin e themelit për të ndërtuar shtëpitë tona të shëmtuara. Betohemi për Perëndi, por e kemi ves ose t'i shkatërrojmë, ose t'i vjedhim, ose t'i zaptojmë edhe faltoret e Perëndisë.



Ne përgjërohemi për Pavarësinë, por patriotët që firmosën nën flamur, i kryqëzuam me harresë, festojmë ditën e Çlirimit, por urrejmë çlirimtarët që u sollën si pushtues dhe tiranë në Tiranë.

Në Shqipëri është modë dhe dimension i qartë i kulturës së epërme për të treguar se kemi pothuaj 300 ditë me diell në vit, por nuk themi që jemi mësuar me mungesën e furnizimit me energji elektrike; ne mburremi për ujëra të kristalta nga Jugu në Veri, por kemi ujë me orar në çezma. Kemi lumenj të vrullshëm, por po i sakatojmë me babëzi hidrocentralesh. Betohemi për tokën ku na ka rënë koka, premtojmë se do ta mbrojmë deri në pikën e fundit të gjakut, por jemi sjellë me të shumë më keq se pushtuesi më i keq që ka kaluar ndonjëherë në këtë vend. Ndërtojmë pa leje dhe i japim votën kujt nuk na vonon në legalizimin e grabitjes së tokës.

Krenohemi se jemi të fortë si malet, por vazhdojmë t'i rrimë me kurriz detit, marrim borxhe për të ndërtuar rrugë se vaniteti i shoferëve kërkon shpejtësi në asfalt dhe nuk kujtohemi të ndërtojmë porte. Skafet e tangërllikut i mbajmë me flamuj fqinjësh, skafet e drogës i kemi pa ngjyrë partish.

Mburremi për dashurinë e mikpritjen, por nuk e kemi për gjë të madhe të vrasim vëllanë për një gardh. Edhe Kainë, edhe Abelë, ende nuk kemi kuptuar se të duash pafund vendin tënd, nuk do të thotë se duhet të urresh fqinjin. Se më së paku, do të duhet të dish të bashkëjetosh me të.

Në Shqipërinë pothuaj demokratike ku ka zgjedhje, por jo zgjidhje, vendimmarrësit sillen si pjeshka politike në fushata, përkëdhelin flokët e tyre, të pushtuar nga sindroma e trikotilomanisë së gradës së fundit, flasin për atdhe e fe duke ditur se edhe atdheu, edhe feja e tyre është dhe mbetet pushteti. Ata bëjnë sikur thonë të vërtetën, votuesit bëjnë sikur i besojnë.

Në Shqipëri është sport kombëtar të flitet për patriotë dhe tradhtarë. Është rregull dhe jo përjashtim që për dashurinë të flasin të tredhurit, për muzikën të jenë kritikë zdrukthëtarët, për vendin e policit të zgjidhen banditët, për moralin të kujdesen prostitutat dhe për politikën, të vendosin nëpunësit e ngeshëm, që me këtë art i lidh vetëm marrëdhënia prej prostitute me moralin.

Si rregull, për patriotizmin flasin më shumë tradhtarët. Hesht Skënderbeu, por brohoret e boloret gjithë ditën e lume, nipi i tij Hamza.

E megjithatë, festat kujtojnë se jeta është një cikël. Ku çfarë duket se është fund, në thelb është vetëm një fillim i ri. Se fati i Shqipërisë është shkruar ndryshe nga sa do ta donin të paudhët. Se Shqipëria e përdorur prej tyre si një kartë krediti po ndryshon.

Se Shqipëria vërtet nuk ka qenë, siç e shohin romantikët!

Se Shqipëria vërtet nuk është, siç thonë qeveritë.

Por Shqipëria do të bëhet, siç e ëndërrojnë shqiptarët evropianë.

---

BE-së, edhe pse në kushtet e dy krizave të papara për të; Ballkani dhe vendi ynë ishin në përparësitë e asaj presidence; në këtë kuadër, ai kryesoi Samitin kushtuar Ballkanit Perendimor dhe takime të tjera, me praninë dhe të disa ministrave tanë dhe të Kryetarit të Kuvendit.

Në këtë drejtim, por dhe në marrëdhëniet dypalëshe ka luajtur rolin e tij të ndjeshëm ministri i Jashtëm, Jean Asselborn. Me plot 13 vjet në krye të diplomacisë së këtij vendi, ai është "dekani" i ministrave të Jashtëm të BE-së, ndaj dhe fjala e tij peshon shumë. Siç kanë pohuar zyrtarë të lartë të diplomacisë luksemburgase, Asselborn është ndër avokatët dhe mbështetësit më të mëdhenj të proceseve integruese të vendit tonë.

Në shenjë vlerësimi të marrëdhënieve dypalëshe, vitin e kaluar, Luksemburgu caktoi zv. sekretaren e Përgjithshme të MPJ-së, zonjën Nadia Ernzer ambasadore jorezidente për vendin tonë, diplomate karriere me përvojë të gjatë pune me rajonin dhe vendin tonë; duke bashkëpunuar direkt me të për disa vite, qysh kur ishim homologë e deri vonë kur Zonja Ernzer u promovua në hierarkinë e lartë diplomatike të vendit të saj, kam qenë dëshmimtar i kompetencës, rezatimit dhe pozitivitetit të saj mbresëlënës tejet të vlerësuar nga partnerët dhe bashkëbiseduesit. Veç ta dëgjosh se me sa entusiazëm flet ajo kudo pas kthimit nga vendi ynë!

E megjithatë, deri para disa vitesh, pa mohuar ndonjë arritje, sidomos në fushën e nënshkrimit të marrëveshjeve standarde dypalëshe, hapat dhe veprimet tona diplomatike kanë lenë shumë për të dëshiruar. Madje dhe ato shkëmbime intensive vizitash të niveleve të larta deri në vitin 2009 duket se kanë qenë më tepër të nxitura nga nevojat e politikës sonë të atyre viteve për aderimin në NATO dhe pavarësinë e Kosovës. Dhe më i vakët ka qenë aktiviteti ynë diplomatik me këtë vend, madje dhe nga ambasada gjatë periudhës 2009 - 2013, kur dhe mungesa e fondeve ka patur ndikimin e saj. Sa për veprimtari kulturore, publike e ekonomike vështirë se mund të bëhej fjalë. Madje dhe një ofertë cilësore e një kompanie satelitore luksemburgase e dëgjuar në botë për Radio Televizonin tonë u la në harresë, dhe më e kegja pa u treguar korrekt me partnerët.

Në vitet e mëvonshme, ambasada jonë, në Bruksel i trajtoi me seriozitetin më të madh këto mungesa dhe nevojën e dinamizimit të marrëdhënieve me Dukatin e Madh. Edhe pse dosjet e shumta paralele të Belgjikës e sidomos ato të BE-së me të cila është e ngarkuar përfaqësia jonë në Bruksel në pamje të parë linin fare pak vend dhe hapësirë. Mirëpo, titullarja e tij Suela Janina, kjo ambasadore energjike dhe e kudondodhur me bashkëpuntorët e saj ishin të vetëdijshëm se hopi cilësor që kërkohej jo vetëm nuk pengonte, por do të nxiste madje ndjeshëm pozitivisht edhe trajtimin e aspekteve të tjera, deri te axhenda e çeljes së negociatave me BE-në.

Për rrjedhojë, gjatë 3-4 viteve të fundit, me mbështetjen e drejtpërdrejtë dhe të MPJ-së sonë u ndërmorën shumë hapa konkrete në të gjitha fushat që sollën dhe ndryshimet e dëshiruara.

Kështu, në vijim të takimeve të dy ministrave të jashtëm, në prill 2016 u zhvilluan konsultimet e para diplomatike në nivel të drejtorëve të Përgjithshëm. Nga vetëm një herë në vit kur shkohej me rastin e Festës Kombëtare, për mungesë fondesh, por dhe nga "mukajeti", u shpeshtuan aktivitetet nga mikrostafi i ambasadës në Luksemburg; kjo krijoi mundësi për kontakte periode dhe vijimin e problematikës, duke filluar nga ajo e komunitetit të vogël, por cilësor shqiptar.

Ndryshimi tjetër i dukshëm ishte se këto demarshe të diplomacisë zyrtare u shoqëruan efektivisht me aktivitete në kuadrin e diplomacisë së munguar parlamentare, ekonomike, publike, kulturore dhe të qytetare. Falë bashkëpunimit me autoritetet e Dukatit të Madh vendit dhe bashkëatdhetarët tanë, në muajin mars filloi funksionimin shkolla e parë plotësuese në gjuhën shqipe. Po gjatë atij muaji, në bashkëpunim me shoqatën aktive të bashkëatdhetarëve tanë u organizua për të dytin vit radhazi prania në Festivalin Ndërkombëtar të Komuniteteve të huaja me promovime librash, art, muzikë, etj.

Ndërsa, e reja në fushën e biznesit, që erdhi pas përpjekjesh të shumta, ishte krijimi disa javë më parë u krijua Dhoma e Përbashkët e Tregtisë, pa të cilën nuk mund të bëhet fjalë për përparim në këtë fushë. Kryetar i saj është Konsulli i Nderit i vendit tonë në Luksemburg, Vito Cassone, afarist me përvojë dhe dashamirës i sprovuar i vendit tonë; kurse zv.kryetare është e reja Besmira Uruçi, e diplomuar nga Sorbona e famshme, aktualisht shefe departamenti në kompaninë e njohur të fondeve të investimeve "Selectra".

Së fundi, këto hapa dhe arritje u vlerësuan edhe gjatë vizitës së javëve të fundit të Ministrit Asselborn në Tiranë, ku ai rikonfirmoi në instancat më të larta të politikës dhe diplomacisë sonë mbështetjen e mëtejshme në fushën e reformave dhe të çeljes së negociatave të antarësimit në BE.

Ja pse të pranishmit e shumtë e vlerësuan pritjen e përmendur në fillim të këtij shkrimi si "qershiza mbi tortën" e Festës së Pavarësisë dhe të miqësisë ndërmjet dy vendeve.

Gjithsesi, duke shkuar tej atmosferës festive, le ta themi se ka ende mundësi dhe rezerva të pashfrytëzuara, sidomos në fushën e shkëmbimeve kulturore dhe të biznesit. Veçse krahas ambasadës dhe institucioneve luksemburgase që e kanë bërë të vetën, tashmë kërkohet urgjentisht angazhimi serioz i dikastereve dhe agjencive tona përkatëse; sepse kompanitë dhe firmat e biznesit, ato turistike, kulturore dhe artistike në Luksemburg kanë kohë që mirëpresin drejtuesit/ përfaqësuesit e Dhomës sonë të Tregtisë, të AIDA, të Agjencisë së Turizmit dhe të tjerë që kanë vite pa shkelur në Dukatin e Madh.

---

## HOROSKOPI

### DASHI

Keni një këndvështrim të idealizuar të raportit në çift. Por kujdes: duke zgjedhur një dashuri të pamundur, mund të harroni për gjerat e bukura që keni pranë vetes. Do të keni shumë ide pjellore, madje edhe aftësinë praktike për t'i zbatuar ato.

### DEMI

Një projekt i çuar përpara më zgjuarsi do të japë rezultatin e pritur. Nuk ju mbetet veçse të vazhdoni përpara me personat që keni zgjedhur në veprimtarinë e ndërmarrë. Me Diellin që grindet me Hënën përpiquni të mos lëndoni ata që i doni.

### BINJAKET

Fronti i dashurisë është pak i dobësuar. Shumë mendime, shumë ftohtësi, shumë vetëkontroll, shumë të larguar. Nëse do të arrini të ndërthurni fantazinë me sensin praktik, do të arrini një qëllim që ia keni vënë syrin shumë kohë përpara.

### GAFORJA

Me Saturnin në shenjën tuaj dhe Hënën ogurmirë, nuk është me koha t'i lëni gjerat për më vonë. Shikoni thellë brenda vetes dhe përballuni me sqarimet e nevojshme me partnerin. Dëshira juaj për të jetuar i lirë, do të gjejë mbështetje te një mik i dashur.

### LUANI

Qëndroni afër një bashkëpunëtori që ka zakon të flasë pak si shumë. Ka rrezik që të përhapë fjalë jo shumë të mira për ju. Mund t'i kërkoni këshillë kujt të doni, por mos lejoni të ndikoheni për zgjedhje që kanë të bëjnë më fushën e dashurisë.

### VIRGJERESHA

Jupiteri në qiellin tuaj i buzëqesh Hënës dhe Diellit. Sot do të jeni optimist, dhe do t'ia dilni të merrni çdo gjë që doni me angazhim minimal. Potenciali krijues është në nivelet më të larta.

### PESHORJA

Me Neptunin armiqësor, mos bini, kërkoni zgjidhjen më të thjeshtë për të ta bërë rrugën më të lehtë: mund të mbeteni pa gjë! Mos e ekzagjeroni me kritika, nëse një koleg nuk ka qenë në lartësinë e duhur të pritshmërive. Vlen më mirë ta ndihmoni.

### AKREPI

Dëshira për të përfituar nga mundësitë e mira të dhuruara nga Jupiteri dhe Saturni, që i buzëqeshin Hënës te shenja juaj, do të shpërblehet. Jepini punës. Sot do të jeni në humor të mirë, do të keni dëshirë të qëndroni afër dhe të ndihmoni njerëzit.

### SHIGJETARI

Me Plutonin kundra mund t'ju hynë dyshimet dhe druajtja për të hyrë në lojë. Mos kini frikë të ndiqni rrugën që ju thotë zemra. Vazhdoni ta mbani nën kontroll bilancin tuaj ekonomik. Priten shpenzime, madje edhe të papritura.

### BRICJAPI

Me Saturnin që keni kundra, në punë do t'ju kërkohet të bëni një sakrificë të vogël që nuk do ta prisni me buzëqeshje. Duroni. Jupiteri mik është gjithmonë i vëmendshëm, për t'ju shpëtuar nga çdo pengesë që ju del gjatë rrugës së punës.

### UJORI

Hëna kërkon të krijojë dyshime për ato që jeni të sigurt, por nuk do t'ia dalë. Do të reagoni me vendosmëri gjatë një momenti pasigurie. Do të tundoheni t'i tërhiqni përsëri vëmendjen një personi të dashur, por më pas do të hiqni dorë për shkak të sedrës.

### PESHQIT

Nëse arrini ta kapni në ajër mundësinë, do të keni fatin të punoni krah për krah me persona të një niveli të lartë nga të cilët mund të mësoni shumë. Mos harroni ata që ju kanë treguar dashuri, për të ndjekur ëndrrat e lavdisë.

SUPERTURNEU

## FIFA projekton Botërorin e klubeve me 24 skuadra




FIFA po mendon për një format të ri për Botërorin e Klubeve të vitit 2021. Sipas asaj që shkruan e përditshmja spanjolle "Marca", projekti është ende në fazë embrionale, por po hidhen hipoteza rreth disa karakteristikave të turneut që zgjedh klubin më të mirë të planetit në çdo katër vjet. Turneu do të shohë të përfshira 24 skuadra dhe do të përfaqësohen të pestë kontinentet. Europa do të ketë 12 klube dhe kushtet për t'u kualifikuar do të jenë si më poshtë: 4 fitueset e fundit të Ligës së Kampioneve, 4 finalistet dhe 4 skuadrat me koeficient më të mirë në ranking. Nëse klasifikimi do të ishte mbyllur sot, Europa do të përfaqësohej nga 4 klube spanjolle, Reali, Barcelona, Atletiko Mardit dhe Sevilja; dy angleze, Mançester Siti dhe Arsenali, dy gjermane, Bajern Mynih dhe Borusia Dortumund; dy klube portugeze, Porto dhe Benfika, Paris Sën Zhërmeni nga Franca dhe Juventusi nga Italia. Është përzgjedhur vera e vitit 2021 për të shfrytëzuar një periudhë pa Europian dhe pa Kopa Amerika. Amerika e Jugut do të jetë kontinenti i dytë më i përfaqësuar me 5 ekipe. Afrika, Azia dhe Amerika e Veriut do të kenë nga dy përfaqësuese, ndërsa ende nuk është vendosur nëse do t'i caktohet apo jo një klub Oqeanisë. Turneu do të jetë i ndarë në 8 grupe me nga 3 ekipe. Fituesja e çdo grupi do të shkojë në çerekfinale. Skuadrat që do të shkojnë në finale do të luajnë maksimumi 5 ndeshje, ndaj hamendësohet që turneu të zhvillohet brenda 20 ditëve.



Jeton Selimi

### Përballja në kuadër të Kupës së Shqipërisë, Greca dhe Uellison vulosin suksesin

# "Hakmarrja" e Tiranës, thyen 2-0 Vllazninë

## *Bardheblutë kanë shënuar në pjesën e dytë*

Tirana mposht Vllazninë në klasiken e fut bollit shqiptar dhe hedh një hap të sigurt në kalimin e turit të Kupës së Shqipërisë. Për bardheblutë shënuan Greca dhe braziliani Uellison. Tirana hedh një hap të rëndësishëm në mbrojtjen e kurorës së Kupës së Shqipërisë. Bardheblutë kanë thyer Vllazninë në "Selman Stërmasi" me rezultatin 2-0, duke qenë praktikisht me njërën këmbë në çerekfinalet e veprimtarisë. Skuadra e drejtuar nga Ze Maria e ka nisur ndeshjen në sulm, madje duke shënuar që në minutën e 3-të, por gjyqtari Alla ka anuluar golin e Sentamus. Vllaznia do ta rrisë lojën e saj me kalimin e minutave, por nuk do bëjë dëme në prapavijën bardheblu. Në pjesën e dytë 24 herë kampionët kanë qenë më konçizë, ndërsa në minutën e 68-të kanë konkretizuar epërsinë e tyre me golin e Grecës, por duhet theksuar kalimi i shkëlqyer i shtatlartit Ngoo, që çoi në golin e mesfushorit. Vllaznia nuk ka forcë të reagojë, Tirana do të shënojë golin e nokautit me Uellisonin, që në zhvillimet e një këndoreje gjuan saktë me kokë, duke e dërguar topin në shtyllën e largët të Sherrit. Tirana vulos me sukses aktin e parë të hakmarrjes së saj ndaj Vllaznisë, ndërsa pas Bylisit, bëhet ekipi i dytë që arrin të mposhtë një skuadër që militon në Superligë.




**ZE MARIA**

Trajneri brazilian i Tiranës, Ze Maria u shpreh mjaft i lumtur për fitoren e arritur në takimin e parë të Kupës së Shqipërisë. Në prononcimin pas ndeshjes, tekniku deklaroi se skuadra tregoi shpirt të lartë gare dhe rezultati 2-0 është i favorshëm për t'u kualifikuar. 44-vjeçari komentoi sërish çështje e shiritit të kapitenit. "Kishim përballë Vllazninë, një skuadër që luan në Superiore, por ne jemi Tirana dhe do të luajmë gjithmonë për të fituar. Sot (dje) treguam një shpirt të lartë gare dhe arritëm të fitojmë 2-0, që besoj se është një rezultat i favorshëm për t'u kualifikuar, por edhe në Shkodër ne do të shkojmë për të fituar sërish. Të gjithë në skuadër e dinë se kush është kapiteni dhe zëvendëskapiteni, ndërsa në mungesë të tyre, shiritin mund ta marrë kushdo. Unë drejtoj disa profesionistë, që e kuptojnë mjaft mirë zgjedhjen time dhe nuk ka aspak vend për xhelozi. Të gjithë e kishin të qartë pse zgjodha Sentamun kapiten dhe nuk pati aspak probleme në dhomat e zhveshjes", deklaroi Ze Maria.

KUPA E SHQIPËRISË

## Flamurtari dhe Kukësi e bëjnë goleadë, Luftëtari dridhet

Kupa e Shqipërisë ka luajtur 6 ndeshje të turit të dytë, ku nuk kanë munguar goleadat apo edhe rezultatet surprizë. Në grupin A kampionët e Kukësit kanë hipotekuar kualifikimin, pasi kanë mposhtur Erzenin në Shijak me rezultatin 4-1, ndërsa në Lezhë, Skënderbeu ka fituar minimalisht 1-0 ndaj Besëlidhjes vendëse. Takimi më i fortë në këtë grup është luajtur në Kamëz, ku të besuarit e Ramadan Ndreut kanë barazuar 1-1 me Teutën, rezultat ky që favorizon durrsakët në takimin e kthimit. Ndërkohë në grupin B, Flamurtari ka shpërthyer me goleadë në Cërrik kundër Turbinës, teksa ka fituar 6-1, ndërsa tek ekipi i Duros ka shënuar praktikisht gjysma e formacionit. Laçi ka triumfuar në "Roza Haxhiu" ndaj Lushnjës vendëse, ndërsa me rezultatin 3-1 praktikisht ka prerë një biletë për në çerekfinale. Betejë sportive në "Adush Muça", ku Bylisi ka mposhtur Luftëtarin me rezultatin 2-1, gjithsesi goli i vonë i Ramadanit ka mbajtur gjallë shpresat e gjirokastritëve për një kualifikim. Kupa e Shqipërisë do t'i mbyllë takimet e këtij turi me sfidën e "Gjorgji Kyçykut", ku Pogradeci do të presë Partizanin të enjten.

**KUPA E SHQIPËRISË**

**TURI I DYTË**

| | |
|---|---|
| **GRUPI A** | |
| Erzeni-Kukësi | 1-4 |
| Besëlidhja-Skënderbeu | 0-1 |
| Kamza-Teuta | 1-1 |
| Tirana-Vllaznia | 2-0 |
| **GRUPI B** | |
| Bylis-Luftëtari | 2-1 |
| Lushnja-Laçi | 1-3 |
| Turbina-Flamurtari | 1-6 |
| **SOT** | |
| Pogradeci-Partizani | 14:00 |

EPISODI KOMIK

## E mashtrojnë dhe thotë "Forca Inter", Gatuzo kap me shpulla gazetarët

Ivan Xhenaro Gatuzo ka rënë në kurthin e gazetarëve të "Le Iene". Trajneri i ri i Milanit ka vendosur që të bëhet pjesë e një interviste të veçantë të gazetarëve të emisionit investigativ-satirik, duke pranuar t'u përgjigjet pyetjeve të tyre për këtë eksperiencë të re. Gjithçka dukej normale, me Gatuzon që fillimisht justifikonte Montelën duke thënë se "afrimi i lojtarëve të rinj kërkon kohë". Më pas ai bëri të qartë se duhej shumë punë për të kthyer fatin e skuadrës dhe mes të qeshurave tha se kishte marrë urimet e presidentit Silvio Berluskoni. Më pas ai pranoi se kishte folur edhe me drejtuesit kinezë të ekipit që i kishin besuar këtë detyrë. Në këtë pikë, gazetarët e "Le Iene" i propozuan që të përshëndeste në gjuhën kineze me një "Forca Milan", që në fakt ishte "Forca Inter", ndërsa Gatuzo nuk e kuptoi rrengun derisa ia shpjeguan. Reagimi i trajnerit të Milanit ishte i kuptueshëm, kapi gazetarët me shuplaka.



KUPA E BOTËS "RUSI 2018"

## 24 orë para hedhjes së shortit, fillojnë dyshimet për manipulim

Kur mbetet vetëm një ditë nga hedhja e shortit të Botërorit 2018, kanë dalë përsëri në skenë dyshimet e zakonshme për manipulimin e goglave dhe ndarjen e tyre në të ngrohta dhe të ftohta për të favorizuar ekipe të veçanta. Dyshimet u rritën edhe më shumë kur në provat e shortit, të realizuara me praninë e disa përfaqësuesve të mediave, Rusia organizatore përfundoi në grup me skuadra që cilësohen ndër përfaqësueset më të dobëta. Në të kaluarën, ish-presidenti i FIFA-s, Sep Blater, kishte deklaruar se disa shorte në UEFA ishin manipuluar nëpërmjet këtij sistemi. Ndaj dje zyrtarë të institucionit që drejton futbollin botëror u desh të dilnin publikisht para mediave për të sqaruar se nuk do të kishte asnjë lloj truku për të favorizuar skuadra të veçanta. "Nuk ka asgjë të vërtetë", tha Kris Unger, drejtori i garave në FIFA. "Të gjithë topat janë të njëjtë, nuk kanë asnjë ndryshim, nuk duken ndryshe me përjashtim të atyre që janë të kuq, të cilët kanë një qëllim të caktuar. Është gjithçka rastësore që do të përcaktojë grupet në fund të shortit", tha ai.



VENDIMI

## Torino nderon Çapekoensen, ndaj Atalantës me fanellë të gjelbër

Dje ishte një ditë përkujtimi për botën e futbollit. Një ekip futbolli, thuajse i gjithi, u shua në një tragjedi ajrore. Tashmë jemi një vit pas ngjarjes dhe klubi i Çapekoenses e ka kaluar tronditjen e madhe. Për ndeshjen e së shtunës me Atalantën, Torino ka marrë një vendim simbolik: futbollistët e tij do të zbresin në fushë me një fanellë ndryshe, një fanellë të gjelbër për të nderuar lojtarët e ekipit brazilian, të cilët ndërruan jetë në atë tragjedi. Torino është një nga klubet, që e ndjen më shumë këtë ngjarje, pasi shumë vite më parë, në 1949-ën, e ka pësuar vetë një tragjedi të tillë. Ky njoftim është shpërndarë nga vetë faqja zyrtare e ekipit të Torinos në "Twitter", por ajo që bën më shumë përshtypje është fotoja e përzgjedhur. Në këtë foto dallohen futbollistët e Çapokaenses, duke zbritur në parajsë dhe duke u përshëndetur me futbollistët e Torinos dhe Mançester Junajtid, të cilët kanë pësuar po të njëjtën tragjedi. Në vitin 1958, edhe ekipi anglez është prekur nga një ngjarje e tillë.



www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al




Tashmë edhe lundroni!